

FONDACIONI SHOQËRI E HAPUR –
MAQEDONI

**RAPORTI
VJETOR**

| 2017 |



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

Shkurt 2018

|| PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA DERI NË FUND TË VITIT 2017 ||

Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni (FShHM), në kuadër të strategjisë për periudhën 2017-2020, ka drejtuar resurset dhe përpjekjet drejt kthimit të demokracisë dhe sundimit demokratik si qëllim afatgjatë, me anë të:

- Mbështetjes së organizatave qytetare për avancim të fushave vijuese që janë të identifikuar si më të rrezikuara: 1) aktivizmi rinor dhe 2) politikat shëndetësore të bazuar në të drejta të njeriut. Këto organizata kanë ekspertizë relevante, qasje në grupe përkatëse të synimit, koalicione mirë të ndërtuara dhe bazë të alumni, që ju mundëson në mënyrë efikase të artikulojnë strategjitë e tyre dhe të përgjigjen sfidave dhe rrethanave të mundshme.
- Zbatim të katër koncepteve: 1) Mobilizim të organizatave lokale dhe aktivizëm në komunitet; 2) Aksion qytetar për prioritete urgjente reformuese 3) Politika përfshirëse dhe transparente arsimore; dhe 4) Kornizë e përbashkët për përforcim juridik.

Shuma e plotë e mjeteve të shpenzuara për zbatimin e aktiviteteve të FShHM-së në vitin 2017 është 196.127.695 denarë, prej të cilëve 166.393.242 denarë vijnë nga Fondacionet Shoqëri e Hapur, ndërsa 29.734.453 denarë nga donatorë tjerë.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	1
Përmbajtja.....	2
Mbështetja e fushave strategjike.....	3
Koncepte në vitin 2017.....	16

|| MBËSHËTETJA E FUSHAVE STRATEGJIKE ||

Arritje kyçe dhe/ose aktivitete që kanë theksuar punën e organizatave të mbështetura në fushat strategjike të FShHM në vitin 2017

#AKTIVIZMI RINOR

• Forumi Rinor Arsimor •

Një grant me shumë prej 100.000 USD ishte dhënë Forumit Rinor Arsimor (FRA) për realizim të aktiviteteve gjatë vitit 2017, me të cilën u siguroi një hapësirë për aktivizëm dhe mësim të nxënësve të shkollave të mesme dhe të rinjtë në 8 qytete të Maqedonisë: Shkup, Kumanovë, Tetovë, Veles, Negotinë, Prilep, Manastir dhe Strugë, me anë të zhvillimit të *Klubeve Debatuese, Mësojmë të Drejtën dhe Medie/Art* në ligjërata javore. Në periudhën prej shkurt deri më maj 2017, janë vendosur në funksion 29 klube me 280 nxënës, ndërsa në periudhën prej tetor deri dhjetor kanë punuar 34 klube me 380 anëtarë. Në tetor, FRA ka parashtruar kërkesë dhe ka marrë mendim pozitiv nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit të bëjë promovim të klubeve në shkollat e mesme. Me anë të programit të prezantuar nga punëtorë të rinj dhe trajnues nga FRA, klubet kanë trajnuar të rinjtë për shprehje të argumentuar, kanë zhvilluar mendim kritik, kanë edukuar për të drejtat dhe sistemin ligjor dhe kanë ndërtuar shkathtësi për shprehje dhe aktivizëm me anë të artit alternativ.

Ishte zhvilluar një trajnim për gjeneratën e re të ligjëruesve debativ, që me sukses kanë kaluar 22 nxënës të shkollave të mesme dhe studentë nga 5 qytete, si dhe një trajnim për ligjërues të rinj për *Mësojmë të Drejtën*, që kanë kaluar 24 studentë të së drejtës nga 10 qytete. Kanë marrë pjesë 14 debatues në 3 konferenca ndërkombëtare debutuese dhe ngjarje. Janë organizuar 9 vizita të gjykatave lokale dhe institucioneve, me qëllim që nxënësit e shkollave të mesme më mirë të njoftohen me punën e tyre, si dhe vizita e parë e *Mësojmë të Drejtën* në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, në kuadër të së cilës 55 nxënës të shkollave të mesme kanë vizituar shtëpinë ligjvënëse dhe janë njoftuar me Kryetarin dhe me deputetët. Grupi teatror amator i të rinjve Kunstwerkstatt, që funksionon në FRA, ka konkurruar dhe ishte pranuar të zhvillojë shfaqje në Festivalin Teatror të Dramës 2017. Përveç shfaqjes, ata nga juria kanë fituar edhe çmimin kryesor, gjegjësisht Grand Prix të DAF 2017, që është një inkurajim i madh dhe njohje për anëtarët në *Medie/Art*.

FRA ishte një përfaqësues sy-zgjuar dhe aktiv që të rinjtë dhe arsimit të jenë prioritet në politikat. Organizata edhe këtë vit ka marrë pjesë në Procesin e Berlinit dhe pas Samitit në Trieste, përfaqësues të FRA, në bashkëpunim me Federalistë të Rinj Evropian - FRE Maqedoni dhe Këshillin Kombëtar Rinor të Maqedonisë, kanë organizuar konferencën "Politikat Rinore nëpërmjet Procesit të Berlinit". Në konferencën që u zhvillua në QME klubin, para 50 organizatave vendore dhe të huaja të ftuara, kanë biseduar organizatat rinore, Drejtori i Agjencisë për të Rinj dhe Sport dhe ambasadorët e vendeve bartëse të Procesit të Berlinit. Disa muaj pas këtij debati u zhvillua edhe debati i parë publik për të rinjtë dhe për Procesin e

Berlini në Kuvendin e RM-së, në të cilën kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të FRA. FRA ishte aktiv edhe në krijimin e Propozimit të Organizatave Qytetare për Reforma Urgjente Reformuese 2017 (Blueprint) në fushat e Arsimit dhe të Rinjve, Shoqërisë Qytetare dhe Kulturë. Këtë vit ishte ndaluar testimi ekstrën, çështje për të cilën FRA ka parashtruar peticion me 26.000 nënshkrime që në vitin e parë të zbatimit. Organizata ka ndjekur dhe ka dhënë komente dhe rekomandime edhe në proceset e reformave në arsimin e mesëm dhe fillor, ka marrë pjesë në krijimin e ligjit të ri Ligjin për Arsim të Lartë dhe Strategjisë së Përgjithshme për Arsim 2018-2025 dhe ka zhvilluar takime me më shumë institucione, në të cilat ka dorëzuar rekomandime për politikën rinore dhe arsimore.

Radio FRA këtë vit ka pasur mbi 1.000.000 vizitorë, ndërsa gazetarët kanë krijuar më tepër se 4.000 artikuj. 19 emisione të Radio FRA janë lëshuar në eter, me mbi 3.000 dëgjime. Në studion e vet, Radio FRA, ka fillua edhe serinë e parë të video koncerteve me muzikantë vendor alternativ, me titullin Kicks and Gigs. Ekipi i Radio FRA ka përgatitur artikuj, lidhje direkte dhe mënyrë intensive ka mbuluar protestat dhe guerile aksionet, iniciativat për ajër të pastër, reformat dhe problemet në arsim, politikën rinore, sulmet dhe shtypjet mbi shoqërinë qytetare dhe ngjarjet kryesore në vend, për të cilët një pasqyrë të mirë japin top-listat e publikuara: Top 10 ngjarje për të rinjtë që kanë shënuar vitin 2017, Top 10 video të Radio FRA dhe 10 emisionet më të mira të Radio FRA për vitin 2017.

POLITIKAT SHËNDETËSORE TË BAZUAR NË TË DREJTA TË NJERIUT

Në fushën e politikave shëndetësore të bazuar në të drejtat, qëllimin afatgjatë të FShHM-së është të arrihet avancim të politikave dhe praktikave shëndetësore të komuniteteve të marginalizuar (LGBTI, Romët, personat që përdorin droga, punëtorët seksual dhe personat që jetojnë me HIV), me anë të: 1) monitorim dhe analizë të buxhetit shëndetësor dhe kërkim të llogaridhënies nga Qeveria për shpërndarjen e mjeteve maksimale në dispozicion që do të mundësojnë realizim progresiv dhe jo-diskriminues të të drejtave shëndetësore; 2) përfaqësim të reformave për politika shëndetësore në përputhje me nevojat e komuniteteve, dhe 3) mundësim të përfshirjes dhe pjesëmarrje të komuniteteve përkatëse në planifikim, monitorim dhe vlerësim të zbatimit të politikave shëndetësore.

Për arritje të qëllimeve, FShHM ka dhënë grante për: Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE; HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë – Shkup dhe Koalicioni për të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuar.

• Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave - ESE •

Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave - ESE (ESE) në vazhdimësi monitoron dhe analizon proceset buxhetore dhe përfaqësohet në fushën e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale. Në fillim të vitit 2017, në bazë të ndjekjes së buxheteve të programeve preventive shëndetësore, ESE ka promovuar 4 analiza për

zbatim të: Programi për mbrojtje aktive shëndetësore të nënave dhe fëmijëve, Programi për kontrolle sistematike të nxënësve dhe studentëve, Programi për zbulimin e hershëm të sëmundjeve maligne dhe Programi për sëmundje të rralla. Janë zhvilluar dokumente për politika publike, me rekomandime për institucionet kompetente për avancimin e planifikimit dhe zbatimin e katër programeve preventive shëndetësore. Në zbatim e sipër është identifikimi i problemeve të reja prioritar të fushës së shëndetësisë, mbrojtjes shëndetësore dhe përcaktuesit social të shëndetit për monitorim dhe analizë të zbatuar në të dhënat nga hulumtimi në teren, që zbatohet në amvisëritë e cenuar në Komunën e Shuto Orizarës.

Në vitin 2017, ESE ka vazhduar të punojë në fushën e monitorimit dhe analizës së indikatorëve për vdekjen e foshnjave, perinatal dhe maternal, gjatë së cilës ka parashtruar 13 kërkesa për qasje në informacione me karakter publike në 17 ente shëndetësore publike spitalore në të cilat ka departament për akusherë me qëllim të marrjes së të dhënave lidhur me këto indikatorë. ESE ka vendosur bashkëpunim me Institutin për Shëndet Publike për punë në fushën e monitorimit dhe analizës së shkaqeve që ndikojnë mbi rritjen e këtyre indikatorëve gjatë shtatë viteve të fundit.

Me rekomandim të ESE, Qeveria ka detyruar përgjegjësit në Ministrinë e Shëndetësisë të fillojnë me pilotimin e metodologjive për llogaridhënie sociale. Ishte siguruar mbështetje teknike me të cilën Ministria e Shëndetësisë ka identifikuar Programin për Mbrojtje Aktive Shëndetësore të Nënave dhe Fëmijëve, që do të zbatohet pilotimin e metodologjisë për revizion social. Me kërkesë të Ministrisë janë zhvilluar propozim qëllime për pilotim të metodologjisë, propozim-lëndë për monitorim dhe propozim-komuna në të cilat do të pilotohet kjo metodologji. Në periudhën vijuese do të zbatohet një proces i përforcimit të kapaciteteve të përfaqësuese të Ministrisë së Shëndetësisë për zbatim të metodologjisë për revizion social.

Në bazë të analizës së zbatuar të procesit buxhetor në shëndetësi, është përgatitur propozim-dokumenti që përmban zbulime nga analiza e rregullores vendore dhe ndërkombëtare dhe standarde, dokumentet e zhvilluar gjatë zbatimit të procesit buxhetor dhe raportet dhe dokumentet e zhvilluar dhe publikuar nga ana e institucioneve ndërkombëtare dhe organizatat, që kanë të bëjnë me ndikimin e politikave makro-ekonomike, relacioneve bilaterale, ndihmën e huaj dhe partneritet publik-privat për qasjen në mbrojtjen shëndetësore. Zbulimet kanë të bëjnë me periudhën 2011 deri më 2017. Janë përfshirë edhe lidhja dhe ndikimet e ndërsjellë mes anëve të harxhimit dhe shpenzimit të buxhetit si dhe si ndikon ajo mbi buxhetin për shëndetin. Promovimi i analizës së fundit dhe të dokumentit për politikën publike është parashikuar për në fillim të tremujorit të parë të vitit 2018.

Në kuadër të monitorimit dhe analizës së buxheteve për mbrojtje shëndetësore dhe sociale nga perspektiva gjinore, me qëllim që të bëhet analizë për punën e papaguar për kujdes në amvisëritë që kujdesen për personat me sëmundje të rëndë, ishte filluar një hulumtim në nivelin kombëtar. Gjatë vitit 2017 është zbatuar një anketim në teren në 1.450 amvisëri dhe janë përgatitur tre baza me të dhëna (bazë e të dhënave për ngarkimin e pyetësorit nga amvisëritë që kanë persona për kujdes të veçantë, bazë me të dhëna për ngarkimin e pyetësorëve të

amvisërive që nuk kanë persona që kanë nevojë për kujdes të veçantë dhe bazë me të dhëna për ngarkimin e të dhënave për shfrytëzimin e kohës) në të cilat ngarkohen të dhënat nga puna në teren.

Në bazë të analizave të dy granteve për zbatim të Strategjisë kombëtare për Luftë kundër Dhunës Familjare, është përgatitur një dokument që përmban të dhëna për përfaqësimin e dhunës familjare, arritjet e ESE në këtë fushë, zhvillimi i Programit të Përbashkët të OKB-së, krahasim i Programit të Përbashkët me Strategjinë Kombëtare në kuptim të programit dhe këndvështrimin financiar dhe konkluzione.

Ishte përgatitur versioni final i raportit të shkurtë për informim të publikut për mënyrën e zbatimit të projektit për avancim të statusit shëndetësor të nënave dhe fëmijëve nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe ishte financuar nga ORIO programi. Raporti është bazuar në të dhënat e marra nga Mbretëria e Holandës, me anë të procedurës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik, të zbatuar në vitin 2016. Përveç kësaj, Raporti përfshin edhe aspektet vijuese më poshtë: qëllimi i projektit, probleme të identifikuar që duhet të trajtohen me anë projektit, realizimi financiar i projektit, portofoli i aktiviteteve për adresim të problemeve të identifikuar, niveli i transparencës së institucioneve publike për shpërndarjen e informacioneve dhe të dhënat lidhur me planifikimin dhe zbatimin e projektit.

Me anë të pjesëmarrjes aktive në grupin e punës për avancim të efikasitetit të drejtimit me resurse publike – transparenca fiskale [procesi i Partneritetit të Hapur Qeveritar (PHQ)], është hapur çështja e mënyrës së përdorimit të grantit nga ORIO si dhe nevoja për informim të mënyrës së zbatimit të grantit ORIO dhe rezultatet e zbatimit përkatës. Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave janë reviduar dhe aprovuar informacionet që Ministria e Shëndetësisë dhe Sekretariati për Çështje Evropiane duhet të publikojnë në internet faqet e tyre, në lidhje me zbatimin programor dhe buxhetor të grantit ORIO. Këto institucione duhet të publikojnë informacionet në fillim të vitit 2018.

Ishte përgatitur dhe promovuar Raporti në Hije në lidhje me zbatimin e prioritetit 3 (Qasja në Informacione) dhe prioritetit 5 (Drejtimi Efikas i Resurseve Publike - Transparenca Fiskale) nga Plani i Veprimit për Partneritetin e Hapur Qeveritar 2016-2018.

Si rezultat i pjesëmarrjes aktive në këtë grup pune dhe shtypja e vazhdueshme, Ministria e Financave ka publikuar buxhet qytetar të buxhetit të RM-së dhe ndryshime dhe plotësim të Buxhetit të RM-së për vitin 2017.

Në lidhje me avancimin e transparencës dhe llogaridhënies së Qeverisë dhe institucioneve qeveritare që janë të lidhur me realizimin e të drejtave shëndetësore, gjatë vitit 2017, për nevojat e analizës së zbatimit programor dhe buxhetor të programeve preventive shëndetësore, tek 65 institucione publike dhe shëndetësore janë parashtruar 635 kërkesa për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Janë kërkuar informacione dhe dokumente që kanë të bëjnë me: kopje të faturave dhe raporteve, të dorëzuar ose pranuar nga zbatuesit e aktiviteteve programore; kopje të dëftësave nga llogaria e arkës, ku janë evidentuar gjitha të ardhurat dhe daljes nga secila prej programeve preventive nga gjithë institucionet përkatëse;

kopje të përmbledhjeve rekapitullime; informacione për realizimin e secilës prej pikave të programeve, etj. Me qëllim të konfirmimit të saktësisë dhe kontrollimit të informacioneve të përmbajtura në dokumentet e Ministrisë së Shëndetësisë, lloji i njëjtë i informacioneve janë kërkuar edhe nga zbatuesit individualisht, me qëllim që të bëhet një krahasim.

Ishte përgatitur një Raport për Nivelin e Transparencës Reaktive për vitin 2016 që pasqyron plotësimin e obligimeve që dalin nga Ligji për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik prej 54 institucione publike, që është përdorur nga ana e institucioneve publike, organizatat qytetare dhe mediet në nivelin kombëtar si burim relevant i informacioneve për prezantim të gjendjeve dhe përparimit të veprimit të institucioneve publike në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik; nisja dhe zbatimi i formave në sistemin publik të RM-së nga kjo fushë; si dhe marrja e masave për avancimin e veprimit të institucioneve publike në procedurat për qasje në informacione me karakter publik. Në vitin 2017, Ministria e Drejtësisë, ka nisur një procedurë për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik. Për të siguruar vazhdimësi në përparimin e institucioneve publike për zbatimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik, në vitin 2017 janë zbatuar gjithsej 1.345 procedura për kërkesën e informacioneve me karakter publike para 68 institucioneve publike dhe janë nisur 120 procedura ankimi.

Raporti për nivelin e transparencës pro aktive për vitin 2016 që pasqyron gatishmërinë e 16 dokumenteve kryesore buxhetore të internet faqeve që 25 institucioneve publike, është përdorur nga ana e institucioneve publike, organizatat qytetare dhe mediet në nivelin kombëtar, si burim relevant i informacioneve për prezantim të: gjendjeve dhe përparimit për publikimin pro aktiv të dokumenteve programore dhe buxhetore; nisja dhe zbatimi i reformave në sistemin publik të RM-së në këtë fushë; si dhe për marrjen e hapave për rritje të numrit të dokumenteve dhe informacionet që do të publikohen nga ana e institucioneve publike. Në vitin 2017, Qeveria ka miratuar listë të dokumenteve dhe informacione që institucionet publike duhet të publikojnë në internet faqet e tyre. Për të siguruar vazhdimësi në përparimin e institucioneve publike në publikimin e informacioneve dhe dokumenteve për punën e tyre programore dhe buxhetore në internet faqet e tyre, në vitin 2017 është zbatuar një monitorim i gatishmërisë së 16 dokumenteve kryesore buxhetore në internet faqet e 25 institucioneve publike.

Në bazë të zbulimeve të monitorimit të zbatuar në nivel të transparencës reaktive dhe pro aktive të institucioneve publike, janë dorëzuar rekomandimet për mbi 70 institucione publike.

Me rekomandim të ESE, Qeveria ka detyruar Ministrinë e Shëndetësisë të përfundojë dhe të publikojë raportet për zbatimin programor dhe buxhetor të secilës prej programeve preventive dhe kurative nga buxheti i Ministrisë, si dhe të zbatojë fushatë për promovimin e tyre. Nga kjo, Ministria e Shëndetësisë, në konsultime të drejtpërdrejta me ESE, ka zhvilluar formate për njoftimin gjysmë vjetor dhe vjetor programor dhe buxhetor për secilën prej 22 programet preventive dhe kurative të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë. Në janar të vitit 2018, Ministria për herë të parë duhet të publikojë këto raporte në internet faqen e saj. Si

përgjigje e pjesshme e përpjekjeve dhe shtypjeve të vazhdueshme për rritje të numrit të dokumenteve programore dhe buxhetore që do të publikohen në internet faqet e institucioneve publike, në tetor 2017 Qeveria ka miratuar listë me dokumente që ministritë kanë për obligim të publikojnë në internet faqet e tyre. Në kuadër të listës është parashikuar publikim të gjithsej 21 dokumenteve dhe të dhënave për punën programore dhe buxhetore të ministrive.

Për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të së Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione janë publikuar tre histori individuale të qytetarëve për pengesat me të përballohen për realizim të së drejtës për qasje në informacione me karakter publike, është promovuar një film dokumentar për përvojën praktike të zbatimit të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik dhe për respektimin e të drejtës për qasje në informacionet (kanë shprehur përvojat e tre organizatave – ESE, CEA dhe BIRN) dhe është zhvilluar konferencë për shtyp të plotësuar me debat publik, në lidhje me filmin dokumentar dhe zbulimet nga raportet për nivelin e transparencës reaktive dhe pro aktive.

Në raportin “Prokurimet Publike – Zonë Gri në Sektorin Publik Shëndetësor” janë identifikuar mungesat kryesore të zbatimit të 7.054 procedurave për prokurime publike nga ana e 62 institucioneve publike-shëndetësore në periudhën prej 2011-2015 dhe janë dhënë rekomandime për tejkalim të mungesave nga ana e institucioneve përgjegjëse. Përveç kësaj, gjatë vitit 2017, me qëllim të prezantimit të përparimit/mbrapsjes në këtë fushë, ka vazhduar monitorimi i procedurave për prokurime publike nga të njëjtat institucione publike-shëndetësore gjatë viteve 2016 dhe 2017. Zbulimet dhe rekomandimet që kanë dalë nga analiza ishin dorëzuar tek 62 institucionet e monitoruar si dhe tek Qeveria e RM-së, Ministrinë e Financave dhe Byronë për Prokurime Publike. Në vitin 2017, Byrja për Prokurime Publike ka prezantuar mundësi për publikim të kontratave të dhëna për prokurime publike mbi procedurat për dhënien e kontratës për prokurim publik, gjatë së cilës, i gjithë opinioni do të ketë kontroll mbi ato.

Si rezultat i përvojës me përdorimin aktiv të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publike si dhe pjesëmarrës aktiv në grupin e punës për qasje në informacione në kuadër të OVP, janë dorëzuar në Ministrinë e Drejtësisë propozime për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Qasje në Informacione me Karakter Publik.

Përveç kësaj, në vazhdimësi punohet në ngritjen e vetëdijes tek publiku më i gjerë për rëndësinë e transparencës fiskale dhe nevojës për rritje të nivelit aktual të transparencës së institucioneve publike, me anë të sigurimit të informacioneve dhe materialeve edukative dhe video në kuadër të fushatës së mediave sociale *Transparenca Fiskale Maqedoni* dhe internet faqja tematike www.fiskalntransparentnost.org.mk. Në kuadër të fushatës janë publikuar 312 informacione individuale dhe video, që kanë 1.200.000 shikime ndërsa përmbajtjet e publikuar në internet faqen tematike janë vizituar nga 1.671 persona.

Në kuadër të fushatës për promovim të punës së plotë dhe rezultatet nga puna e ESE, si pjesë e mbështetjes financiare të FShHM, janë përgatitur dhe publikuar 312 informacione individuale dhe video, që janë shikuar 1.276.000 herë.

Në bashkëpunim me Komisionin për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik është filluar planifikimi për zbatimin e fushatës për ngritjen e vetëdijes publike për të drejtën e qasjes në informacione me karakter publik.

Gjatë vitit 2017, është siguruar mbështetje e vazhdueshme teknike për tre organizata qytetare rome, për zbatimin e aktiviteteve në fushën e llogaridhënies sociale dhe përforcimit ligjor (përgatitja e kartelave të rezultateve, përgatitja e planeve lokale strategjike për përfaqësim dhe trajnim për analizë të të dhënave nga procedura për monitorimin e buxheteve të enteve publike shëndetësore në nivelin lokal. Janë zbatuar dy punëtori me dy organizata qytetare nga Rumania për planifikim të punës së tyre në fushën e llogaridhënies sociale për avancim të shëndetit dhe qasjes në mbrojtje shëndetësore për romët nga komunitetet rome të rrethinës së Bukureshtit dhe Kluzh.

Gjatë vitit 2017 janë zbatuar 6 trajnime treditore për monitorim dhe analizë të buxheteve dhe të përfaqësimit buxhetor, në të cilën kanë marrë pjesë më shumë se 200 persona, përfaqësues të organizatave qytetare nga Lituania, Xheorxhia, Bullgaria, Ukraina, Bjellorusia, Kazakistani, Taxhikistani, Serbia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina dhe nga Maqedonia. Ishte përgatitur një manual për monitorim buxhetor dhe përfaqësim, të synuar për organizatat që punojnë në fushën e zvogëlimit të dëmeve nga përdorimi i drogave. Ishte siguruar mentorim për zbatimin e monitorimit buxhetor dhe përfaqësimit të pesë organizatave qytetare nga RM-ja, platformën kombëtare për parandalim nga HIV, Rrjetin Euro-Aziatik i organizatave që punojnë në fushën e zvogëlimit të dëmeve dhe Rrjeti Rajonal për Droga dhe Politika të Evropës Juglindore.

Pas ndryshimit të kontekstit politik dhe hapjes së institucioneve për bashkëpunim me organizatat qytetare, ESE ka filluar një informim të plotë të ministrave relevant për zbulimet e deritanishme dhe rekomandimet për përfaqësim në fushat në të cilat punon. Janë realizuar takime me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe me Ministrin e Shëndetësisë. Për të prezantuar punën dhe kërkesat në kuadër të programit për monitorim dhe analizë të buxheteve, është dorëzuar informacion dhe kërkesë për takim me Ministrin e Financave dhe me Kryeministrin e RM-së.

Përveç kësaj, përfaqësues të Shoqatës ishin përfshirë në disa procese përfshirëse: procesin për ndryshime dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtje Shëndetësore, të nisur nga Ministria e Shëndetësisë dhe procesin e përgatitjes së *Propozimit të Organizatave Qytetare për Reforma Urgjente Demokratike*, të organizuar nga FShHM-ja dhe një grup i organizatave qytetare.

• HOPS – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup •

Shoqata HOPS – Opsione për Jetë të Shëndetshme Shkup, gjatë vitit 2017 ka punuar në mbështetjen dhe avancimin e gjendjeve në lidhje me: personat adoleshentë që përdorin substanca psikoaktive (PAS); persona që përdorin droga dhe punëtorët seksual. Pas pëlqimit të marrë nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) për punë me persona adoleshentë nga Enti Publik për Fëmijë dhe të

Rinj me probleme edukative-sociale, ishte mundësuar që të zhvillohen punëtori me të cilat do të përforcohet rezistenca e fëmijëve në lidhje me sfidat e përdorimit të drogave. Në periudhën qershor – shtator janë realizuar 4 punëtori për gjithsej 37 fëmijë, në të cilat, me anë të lojës janë arritur qëllimet e përmirësimit të relacioneve mes fëmijëve, pranimit të tyre të ndërsjellë dhe nxitje drejt përmirësimit të pasqyrës pozitive për veten, në planin afatgjatë, në funksionimin e përditshëm dhe përmirësimin e sjelljes së tyre. Përveç kësaj, nga MPPS-ja është marrë edhe mbështetje për aktivitetet në teren me persona adoleshentë që përdorin PAS. Mbështetja ka të bëjë me Qendrën Ditore për Rehabilitim dhe Ri-socializim për përdoruesit e drogave dhe për familjet e tyre, në të cilën është me rëndësi të theksohet që është siguruar mbulim të një ndërrimi plotësues në teren për fëmijët përdorues të PAS dhe për familjet e tyre. Në këtë periudhë janë realizuar gjithsej 161 vizita. Nga qershori deri në gusht, aktivitetet në teren janë zhvilluar dy herë në javë, ndërsa nga shtatori, tre herë në javë, në vende të Komunës së Qendrës (Parku Zena, Kisha e Madhe, QTQ, Tregu i Gjelbër, Parku i Qytetit, Stacioni hekurudhor dhe rrethina e Spitalit Shtetëror) dhe në komunat Kisella Voda dhe Shuto Orizare. Janë dhënë gjithsej 316 shërbime sociale për informacione dhe konsultime dhe udhëzime dhe shoqërime të klientëve. Të gjithë fëmijëve të kontaktuar në teren ju transmetohen informacione për pasojat dëmtuese të thithjes së ngjitëses, si dhe për dëmin nga përdorimi i llojeve të ndryshme të drogave në kohën e njëjtë (marihuanë, tableta).

Në vitin 2017 janë siguruar gjithsej 979 shërbime për fëmijët dhe për familjet e tyre, që kanë të bëjnë me informacione për ndihën sociale dhe mbrojtje, marrja e dokumenteve personale, shërimi nga varshmëria, ndihmë materiale në formë të ushqimit, veshmbathjeve dhe materialeve higjienike. Janë kontaktuar 27 fëmijë të ndryshëm që përdorin PASM prej të cilëve 4 prej tyre janë të kontaktuar për herën e parë.

Përveç aktiviteteve të përmendura, për shkak të natyrës specifike të intervenimeve në mënyrë të rregullt zhvillohen takime individuale dhe në grupe për ngritjen e kapaciteteve të ekipit në teren që punon me fëmijë që përdorin droga. Dy punëtorë ekspert nga HOPS (prej të cilëve njëri është punëtor social në teren me fëmijë adoleshentë) kanë marrë pjesë në takimin rajonal në kuadër të Projektit Rajonal për Përforsim Social të të Rinjve në Rrezik (ARSYE – At-Risk-Youth Social Empowerment) të financuar nga BE-ja. Takimi u zhvillua në Herceg Novi, Mal të Zi.

Në drejtim të përforsimit të sigurimit të kushteve përkatëse për trajtim të fëmijëve që përdorin PAS, gjatë periudhës së fundit janë ndërmarrë aktivitete për aktualizim të çështjes për hapjen e qendrave për kurim dhe rehabilitim të përdoruesve adoleshentë. Radio FRA ka përgatitur një artikull për një fëmijë që përdor droga, në të cilën bisedon me të ëmën e fëmijës që ka filluar trajtimin dhe është dhen deklaratë nga një prej punëtorëve në teren të HOPS. Në shtator, në kuadër të Projektit Rajonal për Përforsim Social të të Rinjve në Rrezik (ARSYE – At-Risk Youth Empowerment) është formuar një trup koordinues kombëtar për fëmijët që përdorin droga, për të avancuar kontrollin dhe ndjekjen e gjendjes në nivelin kombëtar, si dhe të sigurohet platformë për gjetjen e zgjidhjeve gjithëpërfshirëse, të

qëndrueshme dhe financiarisht të mundshme, me anë të bashkëpunimit thelbësor mes gjithë palëve kompetente dhe të përfshira. Trupi Koordinues është përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve, Avokati i Popullit, UNICEF, Kryqi i Kuq i RM-së dhe HOPS. Në periudhën vijuese ka mendime që trupi të zgjerohet edhe me përfaqësues të palëve tjera të interesuara dhe institucione.

Në lidhje me aktivitetet për punëtorët social të angazhuar si para ligjor, përveç me anë të trajnimeve në kuadër të kornizës së përbashkët për përfundim ligjor, janë realizuar punëtori plotësuese nga fusha tjera që ju ndihmojnë në punën e përditshme në teren (vendosja e kufijve mes komunikimit privat dhe profesional, aktivizëm mes punëtorëve seksual, diskriminim dhe mekanizmat e mbrojtjes, azili dhe siguruar gjatë udhëtimit në vend të huaj, dhe përvojat nga terreni - probleme me të cilat janë përballuar para ligjorët e angazhuar). Janë zbatuar 3 takime mbikëqyrëse për punën e para ligjorëve të angazhuar në Shkup, Strumicë, Gostivar dhe në Ohër, në të cilat është diskutuar për: bashkëpunim mes para ligjorëve të angazhuar dhe organizatave lokale; për nevojën e zhvillimit të komunikimit të rregullt dhe profesional mes para ligjorëve të angazhuar në gjithë qytetet dhe kuadrit profesional në shoqatat lokale të qytetarëve; për listat e evidencës që i plotësojnë para ligjorët e angazhuar, në lidhje me kompletimin e informacioneve të dhëna, dhe për studimet e rasteve specifike të prezantuar.

Me kërkesë të punëtorëve profesional që janë kyçur në sigurimin e ndihmës së drejtpërdrejtë për punëtorët seksual, me qëllim të sigurimit të mbështetjes për parandalim të djegies së tepërt (burn out), janë realizuar 14 takime me psikolog. Pas zhvillimit të seancave të vazhdueshme për parandalimin e djegies së tepërt, tek punëtorët profesional vërehet rritje të efikasitetit të punës, rritje të motivimit dhe përmirësim të relacioneve të tyre me kolegët tjerë. Në këto seanca punohet në tejkalimin e problemeve dhe sfidave - si nga jeta profesionale ashtu edhe nga jeta private.

Në lidhje me aktivitetet dhe shërbimet e punëtorëve social për personat që përdorin droga, në vitin 2017 janë kontaktuar 498 përdorues të ndryshëm të drogave (prej të cilëve 89 janë klientë të rinj) dhe janë siguruar gjithsej 5.621 shërbime. Shërbimet sociale janë informacione për sigurimin shëndetësorë, ndihmës sociale dhe mbrojtjes, marrjes së dokumenteve personale, shërimit lidhur me përdorimin e drogave, shoqërime dhe kontakte me institucione, ndihmë materiale, etj.

Në bashkëpunim me punëtorët social dhe anëtarëve tjerë të ekipit, HOPS k vazhduar me motivimin e klientëve të denoncojnë rastet në të cilat janë të akuzuar për vepra personale lidhur me drogë, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes dhe të kontribuohet për përmirësim të trajtimit të personave të varur nga drogat që janë të akuzuar për posedim droge dhe ndryshim të praktikës së kriminalizimit në vend të dhënies së trajtimit, rehabilitimit dhe ri-socializimit. Ndihma juridike falas sigurohet në qendrat e pranimit për përdoruesit e drogave, por edhe sipas nevojave, në teren. Në vitin 2017 janë siguruar 848 shërbime për 115 përdorues të ndryshëm të drogës. Janë denoncuar raste të diskriminimit në institucionet shëndetësore për

shkak të përdorimit të drogave, si dhe largim nga puna pasi që punëdhënësi ka mësuar që i punësuar në të kaluarën ka përdorur droga, por asnjëri nuk ka dashur të nis ndonjë procedurë.

Në lidhje me sigurimin e ndihmës së vazhdueshme ligjor për përfaqësuesit e grupeve të synimit, gjatë vitit 2017 është përfunduar procedura për përcaktimin e diskriminimit në rast të largimit nga puna për shkak të përdorimit të drogave. Gjykatat vendore nuk kanë përcaktuar diskriminimin, por për këtë përgatitet një aplikim në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut në Strasburg. Ishte përfunduar negativ edhe procesi i rastit për mbrojtje të diskriminimit në bazë të gjendjes shëndetësore dhe përkatësisë së grupit të marginalizuar në realizimin e të drejtave për marrëdhënie pune të nisur në vitin 2015. Në gjysmën e dytë të muajit maj është pranuar një aktgjykim me shkrim në të cilën gjykata ka refuzuar kërkesën e padisë si të pabazë. Në afatin e dhënë është parashtruar ankesë për aktgjykimin, ndërsa lënda është ende tek Gjykata e Apelit në Shkup. Në periudhën prill-maj, me vendim të gjykatës për zbatimin e sanksioneve, është ndërprerë zbatimi i dënimit me burg (në afat prej tre muaj) të një klienti me gjendje të rëndë shëndetësore. Pas 12 viteve të vuajtjes së dënimit, personi është lëshuar të shërohet në komunitet, pa dokumente për identifikim personale, me çfarë është vështirësuar qasja në shërbimet shëndetësore. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, personi ka qenë në terapi me metadon. Pas daljes nga burgu, për shkak të mungesës së dokumentacionit të duhur, marrja e terapisë është shtyrë për tre javë. Për shkak të mbrojtjes së të drejtave, ishte përgatitur parashtresë për tek Avokati i Popullit dhe gjykatësi për zbatimin e sanksioneve, për të krijuar kushte për vazhdim të terapisë, por edhe të merren shërbime cilësore shëndetësore për përmirësim të gjendjes së përgjithshme shëndetësore, por të cilën edhe ishte ndërprerë vuajtja e dënimit. Me klientin është përgatitur autorizim për përfaqësim në procedurën për mbrojtjen e të drejtave personale, por për shkak të skadimit të afatit për ndërprirje të zbatimit të procedurës, personi është kthyer në burg që të vazhdojë me dënimin. Në periudhën që vijon janë planifikuar vizita në burgun për shkak të përgatitjes së strategjisë për veprimet vijuese juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij. Në lidhje me lëndën për kërkim të hetimit për shkelje sistematike të të drejtave të punëtorëve seksual para Komisionit për Eliminim të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), me plotësim të dëshmvive, është përfunduar parashtresa në Komisionin. Kjo parashtresë i trajton lëshimet e shtetit në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve seksual nga aksioni policor në nëntor 2008 por edhe në raste tjera para dhe pas kësaj. Ky dokument është parashtruar tek Komisioni dhe është fituar konfirmim për pranim.

Pas ndryshimit të kontekstit politik në vend dhe hapjes së pushtetit të ri për bashkëpunim me organizatat qytetare, janë realizuar takime me Kryeministrin dhe ministrat e shëndetësisë dhe punës dhe politikës sociale në të cilat janë aktualizuar fushat në të cilat punon HOPS.

• Koalicioni Të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuar •

Në vitin 2017, Koalicioni të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuar (Koalicioni) ka vazhduar bashkëpunimin me shumë institucione shtetërore, me qëllim të përforsimit të kapaciteteve të nëpunësve shtetëror për punë me përfaqësuesit e këtyre komuniteteve. Në partneritet me Ministrin e Punës dhe Politikës Sociale ka vazhduar bashkëpunimi me Entin për Veprimtari Sociale për zbatimin e MODULIT 19 për punë me komunitetet e marginalizuar, si pjesë e sistemit të plotë për licencim të punëtorëve profesional në sistemin për mbrojtjen sociale të RM-së. Në dy trajnime ishin trajnuar 50 punëtorë sociale nga qendrat ndër komunale për punë sociale nga më tepër qytete. Ishte marrë vesh që në vitin 2018 përmbajtja e deritanishme e modulit (persona që përdorin drogë, punëtorët social dhe personat që jetojnë me HIV) të plotësohet me temën për LGBTI komunitetin.

Ishte realizuar përfaqësim për tërheqjen e përmbajtjeve diskriminuese nga tekstet mësimore dhe janë dërguar kërkesa dhe parashtresa tek Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD) dhe Avokati i Popullit për 8 tekste mësimore. Janë larguar përmbajtjet nga 3 tekste mësimore, dhe është paralajmëruar revizion i teksteve mësimore për arsimin e mesëm dhe fillor, me të cilat do të largohen përmbajtjet diskriminuese edhe nga tekstet tjera mësimore. Në bazë të rekomandimeve nga Avokati i Popullit (plotësim i rregulloreve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (UKIM) dhe Universiteti "Shën Klimenti i Ohrit" (UKLO) me klauzola kundër diskriminuese), janë dërguar kërkesa tek rektoratet e UKIM dhe UKLO për takim dhe kërkesa për largimin e këtyre përmbajtjeve, por nuk është marrë përgjigje pozitive. Me Ministrinë e Arsimit është firmosur një Memorandum për Bashkëpunim për pjesëmarrje në grupet e punës për revizion të teksteve mësimore.

Në dhjetor 2017, është realizuar fushata mediatike #PERLATAMADEMIKE – DREJT NJË ARSIMI PA DISKRIMINIM që ka pasur për qëllim të prezantohen përmbajtjet diskriminuese të teksteve mësimore për arsim të lartë nga universitet shtetërore të RM-së dhe përfaqësim para institucioneve kompetente shtetërore me qëllim të bëhet revizion i përmbajtjes së këtyre teksteve mësimore. Si pjesë e fushatës ishte organizuar edhe një konferencë njëditore me titullin "Drejt një Arsimi pa Diskriminim: Përpjekje për tejkalimin e diskriminimit nga tekstet mësimore të arsimit të lartë", në të cilën ishte diskutuar për zgjidhjet e mundshme për të tejkaluar përmbajtjet e teksteve mësimore që shkaktojnë shqetësim dhe diskriminim, nxisin paragjykime dhe stigmatizim të komuniteteve të marginalizuar në RM, si dhe kyçe të mundshme të organizatave qytetare gjatë krijimit të përmbajtjeve në tekstet mësimore dhe programet arsimore të universiteteve shtetërore.

Përveç kësaj, është realizuar trajnim i shërbimeve profesionale të shkollave (pedagogë dhe psikologë) për punë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe për përballim me shqetësimin (bulling) në 5 shkolla të mesme pilot nga Shkupi, të identifikuar sipas rasteve të mëhershme të shqetësimit të denoncuar në Koalicion. Janë zgjedhur 3 shkolla në të cilat janë realizuar trajnime me nxënësit dhe

mësimdhënësit për përgatitjen e projekteve/fushatave kundër dhunës së bazuar në gjini në shkollat.

Me qëllim të krijimit të rrjetit referent të mjekësve (me fokus në mjekët e përgjithshëm) me ndjeshmëri të zhvilluar për punë me trans-njerëz, ka filluar bashkëpunimi me Shoqatën e Mjekëve Privat dhe janë trajnuar 25 mjek amë.

Në lidhje me dokumentimin e rasteve të shkeljes së të drejtave seksuale dhe shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe dhënies së ndihmës juridike falas, në vitin 2017 ka vazhduar përfaqësimi i dy personave që në vitin 2013 kanë nisur procedurë para Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (GJEDNJ) për shkelje të së drejtës së privatësisë për shkak të marrjes së paligjshme të ADN mostrës nga ana e MPB-së. Si përgjigje e pohimeve të shtetit pas ankesës së parashtruar, janë përgatitur parashtresa për në GJEDNJ dhe pritet vendimi në periudhën vijuese. Në përfaqësimin e trans-personit, që në vitin 2016 ka nisur procedurë para GJEDNJ për shkelje të së drejtës për privatësi pas refuzimit të ndryshimit të shenjës për gjini në evidencën amë, janë përgatitur parashtresa për në GJEDNJ, si përgjigje e pohimeve të shtetit pas ankesës së parashtruar. Gjithashtu, ka pasur tentim për nisje të procedurës për zgjidhje me marrëveshje të rastit, por shteti u dorëzua. Për 4 raste të njohjes ligjore të gjinisë, përfaqësimi ka vazhduar në nivelin kombëtar dhe 2 prej tyre me sukses kanë mbaruar në shtator 2017, me arritjen e aktvendimit nga ana e Gjykatës Administrative të Republikës së Maqedonisë me të cilën është aprovuar ndryshimi i shenjës për gjini dhe të numrit amë në evidencën amë. Vendimet janë zbatuar dhe dy trans-gra kanë arritur të marrin dokumente për identifikim personal që shënojnë identitetin e tyre gjinor. Procedurat tjera janë në rrjedhë e sipër, ndonëse për njërën paralelisht zbatohet dhe procedurë para GJEDNJ. Në ndërkohë janë filluar dy procedura të reja për trans personat që kërkojnë ndryshim të shenjës për gjini. Tre trans persona kanë marrë ndihmë juridike për ndryshim të emrit të tyre, si pjesë e procesit të tranzicionit. Ka vazhduar përfaqësimi i një trans-gruaje që është viktimë e dhunës nga urrejtja. Në procedurë penale kryerësi është shpallur fajtor, ndërsa këtë vit Gjykata e Apelit ka konfirmuar vendimin, me çfarë procedura është përfunduar dhe trans-gruaja marrë kompensim të shumës për dëmin material që ka pasur si rezultat i sulmit fizik, ndërsa për kompensim të dëmit jomaterial duhet të nisët procedurë para gjykatës qytetare. Në rrjedhë është edhe procedura me anë të së cilës do të paguhet dëmi. Në vitin 2017 kanë vazhduar dy procedura për përcaktim të shkeljes së të drejtave të LGBT personit, që në mënyrë publike ishte ekspozuar në fyerje dhe ofendim. Dy medie në mënyrë publike publikuan orientimin seksual, duke e quajtur të sëmurë mental dhe e kanë keqtrajtuar në mënyrë publike. Kundër dy mediave është nisur procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë qytetare për fyerje dhe ofendim. Dy punëtorëve trans-seksuale ju ishte shkelur e drejta e privatësisë në emision të transmetuar në *Kanal 5*, me anë të publikimit publik të fotografive të tyre, numrave të telefonit, gjendjen shëndetësore, zërin, etj. Kundër redaktorit të emisionit dhe televizionit është nisur procedurë për përcaktimin e shkeljes së të drejtës së privatësisë ndërsa gjatë 2017 ishin zhvilluar disa seanca gjyqësore, por për shkak të ndryshimit të gjykatësit që ka udhëhequr lëndën, procedura do të fillojë nga fillimi. Koalicioni përfaqëson një person që përdor droga që në korrik 2017 ishte rrahur nga ana e katër policëve. Rasti është dokumentuar dhe është

paraqitur tek Avokati i Popullit dhe në Sektorin për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Policore pranë MBP, për të cilën është informuar edhe Prokuroria Publike. Prokuroria Publike ka nisur procedurë kundër policëve ndërsa klienti është përfaqësuar në emër të të dëmtuarit në procedurë para hetimore të cilën e udhëheq Prokuroria. Në vitin 2017 janë identifikuar dhjetë raste të të folurit e urrejtjes ndaj LGBTI në mediet. Në këto raste janë nisur procedura para Këshillit për Etikë në Mediet dhe para KMD. Ankesat para CEEM janë të suksesshme, ndërsa KMD-ja në një rast ka përcaktuar diskriminim ndërsa për tjerët nuk ka ende përgjigje ose nuk është përcaktuar diskriminimin. Janë identifikuar dy raste të të folurit të urrejtjes nga ana e deputetëve, janë dërguar 2 parashtrës në KMD, prej të cilëve në njërin nuk është përcaktuar diskriminim ndërsa për tjetrën nuk ka ende përgjigje.

Në periudhën prej 22 deri 25 qershor 2017, me moton *Trans-Formacione* në shumë vende të Shkupit, Koalicioni në partneritet me LGBTI - Qendrën për Mbështetje pranë Komitetit të Helsinkit dhe LGBT United - Tetovë, kanë organizuar Fundjavën e Krenarisë së pestë. Me anë të ngjarjeve të ndryshme publike – rrëfimi i queer historive, ekspozitë të queer fotografive, instalimeve artistike, ligjërata teorike, drag-cabare dhe punëtori, në publik ishin prezantuar çështjet lidhur me normat shoqërore dhe kulturore të seksualitetit dhe gjinisë, kritika e sistemit binar gjinor, homofobia nacionaliste dhe çështje lidhur me klasën, aspektin etnik, racën dhe statusin shëndetësor. Përveç kësaj, në partneritet me STAR_STAR, në kuadër të ditëve kundër dhunës ndaj punëtorëve seksual, janë organizuar një sërë ngjarjes (ligjërata nga aktivistja për të drejtat e njeriut të punëtorëve seksual Laura Augustin, me titullin “Seks në Margjinat”, performancë publike artistike Skopje Red Light District dhe Marsh të Ombrellave të Kuqe), me qëllim të ngritjes së vetëdijes publike për nevojën e avancimit të të drejtave të njeriut dhe lirive të punëtorëve social.

Ishte zbatuar një hulumtim të prezantimit mediatik të LGBTI temave, është përgatitur raport dhe është parashikuar promovim në fillim të vitit 2018.

Në bashkëpunim me *TV21* është akorduar krijimi i 4 lajmeve/artikujve hulumtuese për të drejtat e komuniteteve të marginalizuara.

Për të përforcuar organizatat, është zbatuar një trajnim për komunikim strategjik për ekipin e Koalicionit dhe përfaqësues të anëtarëve të Koalicionit. Në fund të vitit, Koalicioni ka filluar proces të ri-emërimit në Koalicioni Margjina.

|| KONCEPTE NË VITIN 2017 ||

Përparimi në lidhje me qëllimet kryesore në vitin 2017

|| MOBILIZIM I ORGANIZATAVE LOKALE DHE AKTIVIZËM NË KOMUNITETIN

Koncepti **Mobilizim i Organizatave Lokale dhe Aktivizëm në Komunitet** ka pasur për qëllim të mobilizojë komunitetet për një angazhim të informuar dhe efektiv qytetar në drejtim të avancimit të demokracisë lokale në shtatë komunat në të cilat veprojnë si qendra rajonale.

Me qëllim të **përforcimit të kapaciteteve të aktorëve lokal të shoqërisë qytetare për të angazhuar qytetarët që të japin kontributin e tyre për avancimin e politikave dhe për rritjen e pjesëmarrjes në marrjen e vendimeve në komunitetet e tyre**, në fillim të vitit 2017 ishte publikuar një konkurs për shpërndarjen e komuniteteve për organizata qytetare, grupeve joformale, koalicionet dhe thelbet aktiviste lokale. Në zyrat për konkursin kanë arritur 41 fletëparaqitje për mbështetje institucionale dhe janë shpërndarë 11 grante për mbështetje institucionale (me shumë të plotë prej 240.338 USD) për organizatat qytetare që kanë përvojë dhe besueshmëri në nivelin lokal, që janë të motivuar të përforcojnë rolin e tyre në komunitet, të rritin bazën e tyre të mbështetësve dhe të zhvillojnë kapacitetet e tyre organizative për avancimin dhe drejtimin, dhe që, me anë të veprimtarisë së tyre, kontribuojnë për avancimin e demokracisë lokale dhe të kohezionit social në nivel lokal. Këto organizata veprojnë në shtatë qendra rajonale strategjike të zgjedhura (Prilep, Tetovë, Strugë, Strumicë, Shkup, Kumanovë dhe Shtip).

Gjatë vitit 2017, FShHM ka monitoruar punën e grantistëve dhe ka siguruar trajnime, konsultime dhe mentorim në përputhje me nevojat specifike të identifikuar. Në nëntor dhe në dhjetor ishin organizuar tre trajnime për përfaqësuesit e njëmbëdhjetë organizatave që kanë fituar mbështetje institucionale në vitin 2017. Në trajnimin e parë *Drejtimi me Resurset Financiare dhe Materiale të Organizatës* kanë marrë pjesë njëzet e tre përfaqësues të organizatave qytetare. Pjesëmarrësit kanë pasur mundësi që përfitojnë njohuri për sfidat në punën e përditshme dhe kërkesat nga ana e donatorëve dhe shtetit në kontekst të drejtimit me financiar, si dhe për strategji të dobishme në teknika të drejtimit financiar. Trajnimi i dytë *Menaxhimi Organizativ* ju ka mundësuar njëzet përfaqësuesve të organizatave qytetare të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi për drejtimin me punën e organizatave të tyre. Pjesëmarrësit në trajnim ishin më tepër të interesuar për menaxhimin me resurse njerëzore, planifikimin e projekteve dhe krijimit të kornizës logjike, si dhe për procesin e planifikimit strategjik. Në trajnimin *Sigurimi i Mbështetjes nga Komuniteti*, shtatëmbëdhjetë përfaqësues të organizatave qytetare kanë pasur mundësinë të përfitojnë njohuri që do të ndihmojnë në sigurimin e mbështetjes nga komunitet lokale. Interes më të madh ka shkaktuar përcaktimi i faktorëve të jashtëm që ndihmojnë mbi punën e organizatave, palët kryesore të përfshirë dhe përdoruesit, kycja e komuniteteve në drejtim të realizimit të qëllimit të organizatave, vendosja e prioriteteve dhe planifikimit aksionar.

Në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik Raportues Hulumtues Maqedoni, FShH ka organizuar dy punëtori të synuar për përfaqësuesit e mediave lokale. Punëtorja e parë, e organizuar në nëntor, ishte në temën "Gazetari Hulumtues" dhe në atë kanë marrë pjesë trembëdhjetë përfaqësues të mediave lokale në gjithë Maqedoninë. Ata kanë pasur mundësi të zgjerojnë njohuritë e tyre për procesin e gazetarisë hulumtuese, për mënyrën e zgjedhjes së lajmit hulumtues dhe të bindet redaktorit që hulumtimi është i rëndësishëm. Gjithashtu, kanë mësuar të strukturojnë lajmin dhe të hulumtojnë burimet, por edhe përbalimin me kurthet gjatë krijimit të lajmit. pjesëmarrësit janë njoftuar me veglat për krijimin e lajmeve hulumtuese, me theks të veçantë mbi Ligjin për Qasje të Lirë në Informacione dhe zbulimi i korrupsionit në prokurimet publike. Në punëtorinë e dytë me temë "Mediat si e Mirë Publike", e zhvilluar në dhjetor, kanë marrë pjesë rreth dhjetëra pronarë dhe redaktorë kryesor dhe përgjegjës të mediave lokale dhe rajonale që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në diskutimin e dedikuar gazetarisë profesionale dhe të përgjegjshme, në dobi të interesit publik. Një vëmendje e veçantë u dedikua analizës së problemeve aktuale dhe sfidat për një sferë të pavarur mediatike, por edhe janë identifikuar praktikrat e mira të deritanishme dhe përvojat në lidhje me rolin e mediave në promovimin e temave me interes publik. Në punëtorinë janë shqyrtuar edhe mundësitë e papërdorura për krijimin dhe zbatimin e strategjive të qëndrueshme që do të kontribuojnë për mbrojtjen e standardeve profesionale, nga njëra anë, dhe e mira publike, në anën tjetër. Përfaqësues të Këshillit të Agjencisë për Medie Elektronike nga Kroacia kanë shkëmbyer përvojat e tyre, leksionet e mësuara dhe sfidat kur bëhet fjalë për mbështetjen e mediave lokale, interesit publik dhe vetë-rregullimi.

Në nëntor 2017 ishte publikuar konkurs për mbështetje të përgatitjeve dhe publikimit të lajmeve hulumtuese që dëshmojnë për shkeljet e politikave dhe praktikave aktuale, sugjerojnë përmirësime dhe miratimin e politikave të reja më transparente dhe përfshirëse dhe motivojnë një angazhim më të rritur dhe bashkuar të qytetarëve, shoqërisë qytetare dhe të autoriteteve lokale për tejkalimin e gjendjeve të pavolitshme. FShHM ka mbështetur 6 propozime nga gazetarë që kanë fituar grante për përgatitje dhe publikim të lajmeve hulumtuese që trajtojnë çështje me interes të komuniteteve lokale, me shumë të plotë prej 7.970 USD. Lajmet duhet të përgatiten dhe publikohen deri në mars 2018. Për përgatitjen e katër lajmeve të mbështetur, FShHM do të sigurojë mbështetje mentorimi nga ana e gazetarëve me përvojë.

Siç ishte parashikuar në Strategjinë për vitin 2017, me qëllim të **mbështetjes së sinergjive lokale për ndikim më efektiv mbi krijimin e politikave dhe krijimit të rrjeteve të mbështetësve**, ishte publikuar konkurs për shpërndarje në granteve për mbështetjen e ad-hoc iniciativave të organizatave qytetare, grupeve joformale, koalicionet dhe thelbet lokale të aktivistëve. Në tre ciklet e publikimit të konkursit kanë arritur gjithsej 197 aplikime. FShHM ka vendosur të mbështet zbatimin e 25 iniciativave lokale, me të cilët do të përforcohet zëri i shoqërisë qytetare në lidhje me çështjet lokale të interesit të qytetarëve- në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar.

Në korrik 2017, FShHM, bashkë me organizatat qytetare¹ që kanë marrë pjesë në përgatitjen e dokumentit ["Propozim për Reforma Urgjente Demokratike"](#) (publikuar në korrik 2016, ndërsa në opinion është i njohur me emrin blueprint dokument) ka organizuar forumin "Propozim të Organizatave Qytetare për Reforma Urgjente Demokratike". Në forumin kanë marrë pjesë 146 persona, përfaqësues të 73 organizatave qytetare, ekspertë dhe shkencëtarë, që duke marrë parasysh rrethanat e ndryshuara, kanë reviduar dhe plotësuar dokumentin fillestar dhe kanë përgatitur një version të ri të ["Propozim të Reformave Urgjente Demokratike"](#). Fushat e politikave publike të përpunuar në dokumentin janë: financat publike dhe ekonomia; jurisprudenca; lufta kundër korrupsionit; zgjedhjet dhe sistemi zgjedhor; administrata publike; kontrolli mbi policinë dhe agjencitë e sigurisë dhe (kundër)zbulim; Kuvendi, shoqëria qytetare; mbrojtja sociale; mirëqenia dhe qëndrueshmëria; arsimi dhe politikat rinore; mjedisi jetësor; energjetika; kultura dhe shëndetësia. Ky dokument është një udhërrëfyes për atë se çfarë është më e rëndësishme dhe çfarë duhet të bëhet në 12 muajt vijuese për të kthyer standardet dhe vlerat demokratike, për arritje të përparimit në fusha të caktuara të politikave publike, si dhe kthim të besimit të qytetarëve në institucionet kryesore shtetërore. Dokumenti ishte prezantuar publikut në konferencë për shtyp që u zhvillua në korrik të vitit 2017, në të cilën ishte prezantuar propozimi i shoqërisë qytetare që të përfshihet në konsultime me qeverinë, me anë të krijimit të këshillit konsultues në Qeverinë e RM-së, në të cilin do të merrnin pjesë organizatat qytetare, emërimi i personave për kontakt në ministritë, si dhe pjesëmarrje të organizatave qytetare në trupat e punës së Kuvendit të RM-së.

Klubi i Qytetarëve për Maqedoni Evropiane (QME-klubi) ka vazhduar të jetë platforma për shprehjen e mendimit kritik publik dhe hapësirë e hapur e gatshme për gjithë organizatat qytetare dhe grupe joformale. Janë zhvilluar gjithsej 152 ngjarje (105 takime dhe punëtori pune, 25 prezantime dhe konferenca për shtyp, 8 promovime të librave, 12 debate publike, një ekspozitë të revistave me vizatime dhe panair i librit) për çështjet e lidhura me të drejtat e njeriut, të rinjtë, grupet e marginalizuar, barazia gjinore, reformat e institucioneve dhe arritja në BE. Në këtë ngjarje, të organizuar nga FShHM dhe 55 organizata, grupe joformale, publikues dhe individë, kanë marrë pjesë 3.721 vizitorë.

Në vitin 2017 janë shtypur katër librat vijuese: "Për atë politikën" të Shantal Muf, "Mendja Populiste" të Ernesto Lakalo, "Siguri, Teoria, Popullatë" të Mishel Fuko dhe "Nën-Kultura: Rëndësia e Stilit" të Dik Hebdish. FShHM-ja pjesërisht ka ndihmuar edhe shtypjen e librit "Jeta në Kuti" të autorit Tomisllav Krezharovski. Ishte siguruar mbështetje prej 15.000 USD për ueb portalin www.okno.mk, që paraqet një qendër dhe vend mbledhje të gjeneratave të reja kreativ dhe kritik, kryesisht në fushën e kulturës dhe aktivizmit dhe krijon përmbajtje të reja të besueshme, kreative dhe cilësore mediatike. FShHM-ja ka siguruar mbështetje për dy përfaqësues nga Maqedonia, të në festivalin e filmit Motovun kanë prezantuar

¹ Asociacioni Qytetar MOST; Instituti për Demokraci *Societas Civilis*; Instituti për Politika Evropiane; Instituti për Studime Komunikimi; Eurothink – Qendra për Strategji Evropiane; fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni; Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut të Republikës së Maqedonisë; Qendra për Analiza Ekonomike; CIVIL – Qendra për Liri; Dragi Gocevski

rolin e shoqërisë qytetare dhe format e ndryshme të veprimit qytetar dhe aktivizëm në kohën e krizës së thellë politike në Maqedoni dhe kanë pasur mundësi të shkëmbejnë mendime me aktivistët e vendeve tjera.

FShHM-ja ka firmosur marrëveshje për bashkëpunim me Institutin për Analiza Sociale - Shkup për të zbatuar një hulumtim të mendimit publik *Kultura Politike dhe Identitetet*, që do të prezantohet në opinion në gjysmën e parë të vitit 2018.

Në fillim të vitit 2017 ishte përgatitur raporti përfundimtar për zbatimin e **Projektit të USAID për Shoqëri Qytetare (2012-2016)** dhe ishte zbatuar revizion i fundit për Projektin.

Në shkurt FShHM-ja ka organizuar konferencën përfundimtare në kuadër të **Programit Rajonal për Mbështetje të Hulumtimeve në Ballkanin Perëndimor (PRMH)** në temën *Sidat dhe Mundësitë për Financim të Hulumtimit Shkencor në Republikën e Maqedonisë*, që ishte promovuar edhe publikimi me titullin e njëjtë, gjegjësisht ishte prezantuar propozim-modeli për financim të veprimtarisë shkencore-hulumtuese në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, ishin shkëmbyer përvojat sllovaqe dhe finlandeze në këtë temë. Në konferencë ka pasur më tepër se 100 pjesëmarrës - kuadro shkencor nga institucionet publike dhe private të nivelit të lartë dhe ato shkencor, përfaqësues të drejtuesve universitar, organizatat hulumtuese dhe individë.

Projekti i USAID për Pjesëmarrje Qytetare (PPQ) është projekt prej pesë viteve (2016-2021) në vlerë prej 9.4 milion dollarë, që ka për qëllim të përforcojë kapacitetet e organizatave qytetare dhe grupeve rinore për avancim të politikave publike, përmirësim të shërbimeve publike, promovim të sundimit të mirë dhe kontribut për standard jete më të mirë në Maqedoni. Projektit i USAID për Pjesëmarrje Qytetare zbatohet nga East –West Instituti për Menaxhim, në partneritet me katër organizata lokale: Metamorfozis – Fondacioni për Internet dhe Shoqëri, Asociacioni për Iniciativa Demokratike, Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni dhe Këshilli Kombëtar Rinor i Maqedonisë.

Projekti përbëhet nga katër komponentë: 1. Përforcimi i aleancave/rrjeteve të organizatave qytetare; 2. Përforcimi i organizatave qytetare; 3. Përforcimi i pjesëmarrjes së të rinjve, dhe 4. Përforcimi i aktivizmit rinor.

Roli i FShHM-së është të koordinojë aktivitetet për zhvillim të kapaciteteve të grantistëve, të mbështetur me secilën prej katër komponentëve të projektit.

Për këtë qëllim, gjatë vitit 2017 ekipi i FShHM-së ka vijuar një trajnim nga ekspertë ndërkombëtar për përdorimin e dy veglave: Net-Map analizë për rrjete të organizatave qytetare dhe Vlerësimi i Kapaciteteve Organizative dhe Kapacitetet për Përfaqësim – OASA (Organisational and Advocacy Capacity Assessment) të organizatave qytetare dhe rrjeteve. Ekspertët ndërkombëtar gjatë gjithë periudhës kanë mentoruar dhe kanë mbështetur ekipin e FShHM-së.

Në kuadër të komponentit të parë dhe të dytë të projektit, gjatë vitit të parë Projekti për Pjesëmarrje Qytetare ka mbështetur gjashtë organizata qytetare dhe dy rrjete të organizatave qytetare që zbatojnë projekte me kohëzgjatje prej dy deri tre

vite. Me anë të zbatimit të OASA, zyra e projektit të FShHM ka bërë vlerësim të kapaciteteve të gjashtë organizatave. Për vlerësim të kapaciteteve të rrjeteve janë përdorur dy veglat – OASA dhe Net-Map analiza. Pas identifikimit të nevojave ishin organizuar punëtori individuale për planifikim strategjik me secilin grantist. Si rezultat i këtyre aktiviteteve, që kanë përfshirë gjithsej 106 pjesëmarrës, janë përgatitur plane strategjike, plane vjetore dhe plane për përforsimin e kapaciteteve dhe organizatave dhe rrjeteve. Ekipi i FShHM-së ka siguruar mbështetje për zbatimin përkatës, me anë të trajnimeve dhe mentorimit. Deri në fund të vitit 2017 janë identifikuar mentorë që në periudhën vijuese do të punojnë me organizatat dhe rrjetet në përforsimin e kapaciteteve të tyre në fushat të caktuara.

Gjatë vitit 2017, zyra e projektit të FShHM ka zbatuar tre trajnime të avancuara për Mapimin Procesor, Sisteme Organizative për Monitorim dhe Vlerësim dhe Menaxhim me Resurse Njerëzore, në të cilat kanë marrë pjesë përfaqësues të organizatave dhe rrjeteve. Janë zbatuar edhe dy trajnime për të rinj për Menaxhim Projekti dhe Rrjetëzim me grantistët e PPQ të mbështetur me anë të komponentëve për Përforsim të Pjesëmarrjes së të Rinjve dhe Përforsimi i Aktivizmit Rinor. Në trajnimet kanë marrë pjesë gjithsej 61 pjesëmarrës.

Përveç kësaj, janë zbatuar aktivitete për rrjetëzim, mësim nga bashkëmoshatarët dhe vendosje dialog me institucionet (forume për politikë publike). Më saktë, ishin organizuar katër takime për rrethin mësimor (“Learning Circle”) në temën “Interneti dhe Teknologjitë Komunikuese si Vegël për Zhvillim” në të cilën kanë marrë pjesë 53 grantistë të PPQ. Në nëntor ishte organizuar një takim për rrjetëzim të organizatave lokale qytetare për zgjedhjen e nevojave të komuniteteve lokale në Krushevë, në të cilën kanë marrë pjesë 41 përfaqësues të organizatave lokale qytetare dhe organizatat grantistë dhe partnerë të PPQ-së. Ishin organizuar dy ngjarje për promovim të praktikave të mira, njëra në temën "Drejtimi me Rrjetet Formale dhe Joformale të Organizatave Qytetare", ndërsa e dyta në temën "Siguria Kompjuterike e Organizatave dhe Rrjeteve" në të cilat kanë marrë pjesë më tepër se 80 përfaqësues të sektorit qytetar në Maqedoni. Dy forumet për politikë publike kanë përfshirë më tepër se 170 përfaqësues të sektorit qytetar, pushtetin lokal dhe qendror, përfaqësues të sektorit afarist, Akademia, grupet joformale, ekspertët dhe palët tjera të interesuar. Forumi i parë ishte fokusuar në propozim-dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Kulturor 2018-2022, ndërsa e dyta në temën "Qasja Integruese për Mbrojtje të Cilësisë së Ajrit".

Në shtator të vitit 2017 ishte organizuar për herë të parë Java e Organizatave Qytetare me gjithsej 21 ngjarje prej 17 organizatave qytetare në 12 vendbanime, me përfshirjen e 1.350 pjesëmarrës. Karavani i parë i organizatave qytetare në gjithë Rajonin e Pellagonisë ka përfshirë 16 përfaqësues të grantistëve dhe nga partnerët e projektit, që janë takuar me qytetarët e Zhitoshe, Krushevës dhe Krivogashtani dhe kanë biseduar për dhunën e bazuar në gjini, informimi i të rinjve, buxhetimi lokal dhe mënyrat e pjesëmarrjes qytetare për tejkalimin e problemeve lokale në këto fusha, me qëllim të nxitjes së aktivizmit qytetar për zhvillim lokal.

Sulmet mbi 22 organizatat qytetare dhe hyrja e organizuar e organeve të rendit, që ndodhi me urdhër të Prokurorisë Themelore Publike dhe kontrollet e Drejtorisë për të Ardhura Publike, që filloi në dhjetor 2016 dhe ka zgjatur deri më maj 2017, jo vetëm që kërcënuan punën e organizatave qytetare dhe planet e tyre për vitin 2017, por edhe kanë ndikuar mbi imazhin dhe besueshmërinë e tyre dhe kanë pasur pasoja afatgjate negative mbi imazhin e tyre në publik. Si përgjigje të kësaj, FShHM ka mbështetur iniciativën e bashkuar “Të Mbrojmë Shoqërinë Qytetare!” prej 127 organizata qytetare, iniciativa, komunitete, grupe dhe sindikata, që kanë dalë në mbrojtje të sektorit qytetar dhe të zërit qytetar që ka qenë nën kërcënim dhe hajkë të orkestruar nga ana e institucioneve dhe mediave të kontrolluar nga strukturat në pushtet. Në shkurt 2017, FShHM ka organizuar një takim dyditor me përfaqësues të organizatave që kanë qenë të ekspozuar në kontrole, në të cilën diskutohet për nevojën e mbrojtjes së shoqërisë qytetare dhe strategjitë e mundshme për komunikim me publikun dhe përmirësim të imazhit të këtyre organizatave. Këto organizata kanë zhvilluar disa konferenca për shtyp në të cilat kanë informuar publikun për procedurat që zhvillohen kundër tyre dhe shtypjet ekstreme shumë muajsh në të cilën ishin të ekspozuar. Në konferencat për shtyp, përfaqësuesit e organizatave qytetare i kanë shprehur kërkesat për pushtetin - të ndalojë shtypja, të kontrollohet baza e kontroleve dhe të hetohet keqpërdorimi i detyrës zyrtare për shtypje politike dhe diskriminimi, si dhe të anulohen gjobot e përcaktuara dhe procesverbalet nga procedurat e udhëhequra.

FShHM ka siguruar mjete plotësuese nga **fondi rezervë i Iniciativës Evropiane për Shoqëri të Hapur** për të mbrojtur dhe mirëmbajtur punën e këtyre organizatave qytetare dhe të inkurajohen përpjekjet e tyre për të konfirmuar rolin e tyre vital në shoqëri. Ishin shpërndarë 20 grante për ndihmë juridike dhe përfaqësim, konsultim financiar dhe komunikues dhe aktivitete në komunitetin në shumë prej 236.300 USD. Për përforsim të kapaciteteve të këtyre organizatave, në bazë të nevojave të identifikuar ishin organizuar trajnime për temat vijuese: punë financiare, vullnetarizëm, vizualizim të të dhënave dhe komunikim me publikun.

Organizata KADAR – Ekip për Gazetari Hulumtuese dhe Edukim ishte mbështetur për përgatitje të filmit dokumentar “Gjuajtja e Shtigave” që ka pasur për qëllim të merret me hajkën e organizuar të disa institucioneve shtetërore, që zbatohet prej dhjetorit 2016 deri më maj 2017 në 22 organizata qytetare.

Zyra për komunikim të Fondacioneve Shoqëri e Hapur nga Nju Jork ka mbështetur Fondacionin OJQ Infoqendër me 21.960 USD për të analizuar përmbajtjet e publikuar në medie² të dedikuar sulmeve të kurdisura mbi organizatat qytetare, FShHM, Xhorxh Soros dhe tjerë, si dhe dinamika e publikimit të tyre. OJQ Infoqendër ka krijuar raporte javore në të cilat ka analizuar përgjigjen mediatike të hajkës kundër sektorit qytetar dhe ka publikuar [Raport për Monitorim të Mediave në Periudhën prej Mars deri Nëntor 2017](#), me zbulimet e tyre kyçe kanë

² Emisione ditore në TV stacionet kombëtare: TV24, Telma, Sitel, TVM1, Alsat M, Kanal 5, Alfa dhe TV 21; gazetar ditore: Sloboden Pecat, Vecer dhe dnevnik (internet faqet e tyre/botimet elektronike) dhe portalet: A1on, Plusinfo, Republika, Kurir dhe NovaTV.

konfirmuar tendencën për të diskredituar punën e organizatave qytetare dhe FShHM.

|| AKSIONI QYTETAR PËR PRIORITETE URGJENTE REFORMUESE

Qëllimi i konceptit **Aksioni Qytetar për Prioritete Urgjente Reformuese** është përforsimi i rolit të shoqërisë qytetare për monitorim dhe përfaqësim të zbatimit të Prioriteteve Urgjente Reformuese (PUR). Partner strategjik në zbatimin e konceptit është EuroThink – Qendra për Strategji Evropiane.

Qëllimi i parë afatshkurtër i konceptit ishte mbështetja e rrjeteve të shoqërisë qytetare që ndikojnë mbi zbatimin e Prioriteteve Urgjente Reformuese. Ishin identifikuar edhe organizata të rrjetëzuar qytetare që punojnë në fushat e gjyqësorit, mediet dhe lufta kundër korrupsionit.

(1) Në fushën e *Gjyqësorit*, ishte dhënë projekt për Institutin për të Drejta të Njeriut, që e zbatojnë bashkë me Shoqatën Maqedonase e Juristëve të Rinj dhe me Institutin për Politika Evropiane. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është përforsimi i transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit të gjyqësorit. Qëllimet afatshkurtër të projektit të njëjtë janë: (1) Përforsimi i monitorimit strukturor mbi realizimin në Prioriteteve Urgjente Reformuese në gjyqësor dhe (2) Avancimi i debatit publik për zbatimin e PUR në gjyqësor me anë të përfaqësimit qytetar. Ishte përpiluar dhe promovuar raporti i parë "Reforma në Gjyqësor - nga Pribe 1 deri në Pribe 2 dhe pastaj"³ që përfshin periudhën korrik 2015 - shtator 2017.

(2) Në fushën *Mediet*, ishte dhënë një grant për Metamorfozis - Fondacioni për Internet dhe Shoqëri, që e batojnë në partneritet me ShQ Agora - Qendra për Promovim të Vlerave Qytetare dhe PINA - Platforma për Gazetari Hulumtuese dhe Analiza. Projekti *Opservatori e Reformave të Mediave* ka për qëllim të informojë qytetarët për procesin e plotësimit të Prioriteteve Urgjente Reformuese në fushën e mediave dhe lirisë së shprehjes. Qëllimet afatshkurtër janë: (1) Krijimi i koalicionit të organizatave qytetare dhe të mediave për monitorim dhe përfaqësim të plotësimit të PUR në fushën e mediave; (2) Përforsimi i vetëdijes publike në lidhje me PUR dhe sfidat në fushën e mediave, dhe (3) Krijimi i mundësive për debat të informuar publik mes bartësve të vendimeve, OJQ-ve dhe mediave. Në kuadër të konferencës së trembëdhjetë E-Society, me titullin "Liria dhe Privatësia" ishte promovuar raporti i parë tremujor nga monitorimi i plotësimit të prioriteteve reformuese nga fusha e mediave. Në kuadër të projektit të njëjtë, në periudhën korrik – dhjetor 2017 në ueb faqen e agjencisë së lajmeve Meta⁴ ishin publikuar 60 tekste gazetareske/lajme lidhur me reformat në mediet dhe lirinë e shprehjes si dhe 3 analiza në portalin e ri të krijuar nga projekti "Observatori i Reformave Mediatike".⁵

(3) Në fushën e *Luftës kundër Korrupsionit* ishte dhënë një grant Transparencë Maqedoni për promovimin e prioriteteve strategjike të Platformës për Luftë kundër Korrupsionit. Qëllimi kryesor i këtij projekti është nxitja e

³ <https://www.ihr.org.mk/p.php?pid=274>

⁴ www.meta.mk

⁵ <http://mediaobservatorium.mk/>

ndryshimeve dhe përforcimi i demokracisë në shoqëri. Qëllimet afatshkurtër të projektit të njëjtë janë: (1) Pozicionim më të mirë të veprimit të Platformës për Luftë kundër Korrupsionit në shoqëri dhe (2) Rritja e dukshmërisë së Platformës. Me rastin e shënimit të 9 dhjetorit – Dita Ndërkombëtare për Luftë kundër Korrupsionit, Platforma a organizuar një konferencë me titullin "Shteti i robëruar - interesat politik, social dhe ekonomik".

Në kuadër të këtij qëllimi afatshkurtër të konceptit, EuroThink ka përgatitur një analizë të bazuar në dëshmi, me rekomandime për përmirësim të politikës për trupat e pavarur dhe rregullator me fokus mbi energjetikën. Në fazën vijuese të përfaqësimit, këto rekomandime do të referohen në organet përkatëse shtetërore, me qëllim ato të inkorporohen në politikën shtetërore për energjetikë.

Ishte përgatitur dhe promovuar edhe analiza "Sfidat në avancimin me Instrumentin për Ndihmë Para Aderimi"⁶. Në këtë dokument analizohet shfrytëzimi i mjeteve financiare nga BE në Republikën e Maqedonisë, me anë të Instrumentit për Ndihmë Para Aderimit (2007-2013). Gjatë kësaj, theksi është vendosur mbi fondet që menaxhohen me anë të aq. sistem të decentralizuar për zbatim. Qëllimi themelor është që mësimet e fituar nga analiza të përdoren për avancimin e përdorimit të fondeve evropiane, veçanërisht mjetet e Instrumentit për Ndihmë Para Aderimit për periudhën 2014-2020 (IPA2).

Në drejtim të përmirësimit të propozim-politikës për reforma në administratën publike, ishte përgatitur një dokument për politikë publike (policy brief) që përfshin komente të propozim-strategjisë për reforma të administratës publike, të publikuar në qershor 2017⁷.

Përfaqësues të FShHM-së kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në grupet e punës së organizatave qytetare që kanë punuar në mbindërtimin e dokumentit "Propozim i Organizatave Qytetare për Reforma Urgjente Demokratike"⁸ në të cilin japin mendimet e tyre për prioritetet dhe për masat që duhet të udhëheqin programin qeveritar për 12 muajt vijues, dhe në drejtim të plotësimit të Prioriteteve Urgjente Reformuese.

Qëllimi i dytë afatshkurtër i konceptit ishte lehtësimi i dialogut mes shoqërisë qytetare, Parlamentit dhe mediave, që do të kontribuojë për debat të informuar publik për përparimin në lidhje me agjendën e aderimit në BE.

FShHM dhe Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë (MSIA) kanë nënshkruar Marrëveshje për Bashkëpunim⁹, në drejtim të sigurimit të mbështetjes së MSIA nga FShHM, për procesin e krijimit të Strategjisë për Reforma të Administratës Publike (2018-2022). Për këtë qëllim, nga ana e FShHM ishin

⁶ <http://www.fosm.mk/mk/Home/Publication?newsID=10436&catID=10&pageIndex=1>

⁷

<http://www.fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=9384&catID=7&pageIndex=8&month=0&year=0&additionalID=0>

⁸

<http://www.fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=9388&catID=7&pageIndex=8&month=0&year=0&additionalID=0>

⁹

<http://www.fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=10431&catID=7&pageIndex=4&month=0&year=0&additionalID=0>

angazhuar dy ekspertë të jashtëm që kanë bashkëpunuar, kanë dhënë komente eksperte dhe kanë lehtësuar grupet e punës të themeluar në Ministrinë për hartimin e Strategjisë, dhe kanë dhënë kontribut aktiv edhe në hartimin e tekstit final, duke marrë parasysh mësimet nga procesi konsultativ. Mbështetja ka nënkuptuar edhe krijim të indikatorëve për matje të zbatimit të Strategjisë, gjegjësisht me krijimin e tyre do të mundësohet matja përkatëse e rezultateve dhe ndryshimeve që dalin nga reformat e planifikuara.

Ishin të organizuar tre brifingje me gazetarët, me qëllim të rritjes së komunikimit dhe ngritjes së vetëdijes për ruajtjen e agjendës për integrim evropian, me fokus në realizimin e Prioriteteve Urgjente Reformuese në fushat e administratës publike, gjyqësorit dhe mediave.

Një përfaqësues i FShHM në mënyrë aktive ka marrë pjesë në grupin e punës së përbërë nga donatorë në vend, për krijimin e "Udhërrëfyesit për Zhvillimin e Shoqërisë Qytetare 2018-2022" që do të kontribuojë për përcaktimin e rolit të organizatave qytetare. Dokumenti i përfshin fushat e kornizës politike dhe institucionale për OQ-të; financimin shtetëror të organizatave qytetare; rrethina ligjore dhe fiskale mbështetëse për qëndrueshmëri të OQ-ve; roli i OQ-ve në bashkëpunimin me institucionet, qytetarët, sektorin afarist dhe mes vete dhe drejtimi i mirë dhe rritja e besimit në OQ-të.

Përfaqësues të FShHM kanë marrë pjesë në trupat e punës së Kuvendit të RM-së ku kanë dhënë kontribut aktiv në debatin dhe krijimin e politikave publike në lidhje me miratimin e ligjeve të BE-së.

Në kuadër të konceptit, organizata partnere Eurothink ka organizuar katër Eurotalks, seanca edukative-debatuese sipas rregullës Chatham House, në temën "Evropa në Dy Shpejtësi", për relacionet mes BE-së dhe Ruisë, dhe ndikimi i tyre mbi pozicionimin e BE-së si lojtarë global, si dhe për plotësimin e Prioriteteve Urgjente Reformuese, si parakusht për integrim evropian të RM-së.

Projekti **Aleanca Qytetare për Transparencë – Vëzhgim i Procesit të Reformave të Administratës Publike nga e Organizatave Qytetare** ka filluar të zbatohet në janar 2017, me anë të një granti nga programi EK IPA 2 për mbështetje të shoqërisë qytetare dhe mediave për vitin 2015 dhe e zbatojnë FShHM dhe Eurothink – Qendra për Strategi Evropiane. Projekti ka për qëllim të kontribuojë për përforcimin e ndikimit të shoqërisë qytetare në proceset e krijimit të politikave publike. Pritet që me anë të aktivitetet të projektit të avancohen kapacitetet e organizatave qytetare për zbatimin e monitorimit të bazuar në dëshmi të procesit të reformave të administratës publike dhe të mundësohet hapësirë për bashkëpunim të organizatave qytetare në aktivitetet e tyre të përfaqësimit për përmirësim të politikave lidhur me reformat e administratës publike.

Në kuadër të projektit ishte zbatuar skema e parë për ri-grantim, në vlerë prej 50.000 euro. Ishin shpërndarë grante 6 organizatave që kanë zbatuar projekte hulumtuese dhe kanë përgatitur publikime në fushat vijuese: (1) Shoqata e Qytetarëve për Mbështetje të Dialogut Ndëretnik dhe Zhvillim të Komunitetit *Vlera të Përbashkëta* ka hulumtuar ndryshimin e Ligjit për Gjuhët (2008) në trupat e përzgjedhur të shtetit; (2) Koalicioni Rural – Kumanovë ka analizuar mundësinë

dhe përvojën e krijimit pjesëmarrës të politikave të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit; (3) Forumi Rinor Arsimor ka hulumtuar punën e Agjencisë për të Rinj dhe Sport; (4) Shoqata për Demokraci Lokale Qendra e Komunitetit të Komunës së Strumicës ka analizuar punën e Komisionit për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionet me Karakter Publik; (5) Shoqata për Zhvillim të Qëndrueshëm Genera – Shkup ka analizuar procesin e miratimit të politikave në fushën e ndërtimitarisë; (6) Shoqata për Demokraci Lokale – Qendra e Komunitetit të Komunës Qendër ka analizuar procesin konsultues gjatë miratimit të Strategjisë për Reforma në Administratën Publike 2018-2022. Në kuadër të skemës për ri-grantim ishte zbatuar një vlerësim i nevojave të grantistëve, trajnim për ngritjen e kapaciteteve të tyre në përputhje me nevojat dhe ishte siguruar mentorim i vazhdueshëm gjatë zbatimit të aktiviteteve. Ishin zbatuar 10 takime për koordinim dhe krijimin e sinergjive – si mes grantistëve ashtu edhe mes palëve të interesuara (mediat, institucionet) duke kontribuar për rrjetëzimin e tyre joformal.

Në kuadër të projektit ishte zbatuar hulumtim për përcaktimin e njohurisë dhe përvojës së organizatave qytetare me format e administratës publike¹⁰, të plotësuar me vizuelizim të të dhënave, që ishte prezantuar në mënyrë publike në ngjarjen fillestare për promovim të projektit, në të cilën ka marrë pjesë edhe ambasadori i Bashkimit Evropian në Maqedoni Samuel Zhbogar¹¹. Nga ana e 4 organizatave pjesëmarrëse në projektin ishte përgatitur dokument për politikën¹², që ka dhënë një pasqyrë të sistematizuar të komenteve të këtyre organizatave për propozim-strategjinë për reforma të administratës publike. Ishte filluar përgatitja për dokument të dytë për politikën, që do të shqyrtojë çështjen e lidhur me madhësinë e administratës publike në Maqedoni. Eurothink ka zbatuar analizën vjetor të mendimit publik - Eurometar, për çështjet lidhur me administratën publike dhe proceset e integritimit evropian të vendit, që ishte prezantuar në ngjarje ku kanë marrë pjesë përfaqësues të MSIA, Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Avokatit të Popullit, Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë dhe përfaqësues të organizatave qytetare.

Përfaqësues të FShHM-së, Eurothink dhe një pjesë e grantistëve kanë marrë pjesë aktive në grupet e punës së themeluar nga ana e MSIA për krijimin e Strategjisë për Reforma të Administratës Publike 2018-2022, me çfarë në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë kontribuar për përcaktimin e qëllimeve dhe masave të reformave të planifikuara.

¹⁰

<http://www.fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=9378&catID=7&pageIndex=9&month=0&year=0&additionalID=0>

¹¹

<http://www.fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=7301&catID=7&pageIndex=17&month=0&year=0&additionalID=0>

¹²

<http://www.fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=10432&catID=7&pageIndex=1&month=0&year=0&additionalID=118>

|| POLITIKA TRANSPARENTE DHE PËRFSHIRËSE ARSIMORE

Koncepti Politika Transparente dhe Përfshirëse Arsimore ka pasur për qëllim të përforcojë rolin dhe ndikimin e shoqërisë qytetare, si një faktor serioz në krijimin e politikave cilësore, përfshirëse dhe llogaridhënëse. Plani i aktiviteteve për vitin 2017 përbëhej prej hapave vijuese: (1) mapimi i shoqatave të qytetarëve aktive në fushën e arsimit dhe përforcimit të tyre organizativ; (2) grante të vogla për mbështetje të avancimit të portofolit të tyre programor; (3) përforcimi i individëve (nga organizatat e mapuara dhe më gjerë, prej faktorëve të ndryshëm arsimor, me anë të trajnimeve për aspekte të politikave arsimore.

FShHM ka identifikuar 11 organizata/shoqata dhe sipas interesit të shprehur për bashkëpunim, duhet të bëjë vlerësim organizativ të gjashtë prej tyre. Në përputhje me zbulimet nga vlerësimi, ishte përgatitur një plan për trajnime për përforcim organizativ, ndërsa në periudhën korrik-dhjetor janë zbatuar 4 trajnime për përforcim organizativ të shoqatave të mapuara, edhe atë: Udhëheqja me Ciklin Projektues; Trajnim për Drejtim, Punë Financiare dhe Administrative të Organizatave Qytetare; Trajnim për Planifikim Strategjik dhe Punë me Donatorë dhe Mbledhjen e Fondeve (fundraising). Në kohën e njëjtë me trajnimet për përforcim organizativ, FShHM ka mbështetur 5 organizata me grante të vogla (deri më 6.000 USD) për iniciativa që do të zbatohen deri në fund të marsit 2018.

Për shkak të kontekstit të ri dhe mundësisë që bashkë me organizatat tona partnere të ndikojmë mbi krijimin e politikave të reja arsimore, komponenti për trajnimin e individëve për politika arsimore ishte ndryshuar me një sërë aktiviteteve që dalin nga Memorandumi për Bashkëpunim nga MASH, që janë theksuar më poshtë.

Për të siguruar ndihmë ekspertësh për përgatitjen e propozim-modeleve për kontroll të jashtëm të njohurive të nxënësve në RM, FShHM ka ftuar ekspertë nga Sllovenia që kanë pasur dy takime me MASH-in. Në takimin e parë kanë prezantuar modelet për kontrollin e jashtëm të njohurive të nxënësve në Evropë dhe kanë dhënë një pasqyrë më të hollësishme të modelit të kontrollit kombëtar të jashtëm të njohurive të nxënësve në Republikën e Sllovenisë. Në takimin e dytë ata propozuan një model të mundshëm për RM-në, që do të vendoset në kuadër të reformave më të gjera sistemore për sigurim të cilësisë me anë të vetë-vlerësimit të shkollave, zhvillimin profesional dhe të karrierës së mësimdhënësve. Në MASH do të formohet grupi i punës që do të vazhdojë të hartojë këtë model gjatë vitit vijues, me ndihmën e ekspertëve slloven.

Në fund të nëntorit kanë filluar të zbatohen dy hulumtime që do të promovohen dhe shkëmbehen publikisht me institucionet kompetente deri në fund të marsit 2018. Hulumtimi *“Arsimi i Mësimdhënësve në Arsimin Fillor në RM— gjendje dhe perspektiva”* ishte zbatuar nga një ekip i përbërë nga 5 profesorë të fakulteteve mësimore, me qëllim të bëhet analizë të vendosjes ligjore të arsimit fillor dhe praktika të mësimdhënësve të arsimit fillor; të përcaktohen ngjashmëritë dhe dallimet në programet studimore, kompetencat dhe okupacionet e të diplomuarve

të fakulteteve mësimore; përputhja me direktivat evropiane, kompetencat profesionale të mësimdhënësve, në kuadër të kornizës së kualifikimeve; analiza e vendosjes ligjore për atë profesional dhe të karrierës, si dhe analizë të ligjeve që rregullojnë profesionin e mësimdhënies (Akademia e Mësimdhënësve, Ligji për Mësimdhënësit në Arsimin Fillor dhe të Mesëm) dhe që ende nuk zbatohen në praktikë. Hulumtimin “Çmimi i Kostos së Shpenzimeve të Shportës Studentore” e zbatojnë YMAI dhe Forumi Rinor Arsimor, me qëllim të sigurimit të informacioneve për shumën e shpenzimeve të vërteta të studentëve që studiojnë në universitetet shtetërore në Maqedoni si dhe standardi i tyre i jetës. Me hulumtimin janë përfshirë rreth 600 studentë të rregullt në studimet diplomike të universiteteve shtetërore në Shkup, Ohër, Shtip, Tetovë dhe Manastir edhe atë sipas kategorive vijuese: studentë që jetojnë dhe studiojnë në qytetin e lindjes; studentë që studiojnë dhe jetojnë jashtë qytetit të lindjes; studentë që vazhdimisht udhëtojnë nga vendi i lindjes deri në qytetin në të cilin gjendet fakulteti. Të dhënat dhe raporti i studimit do të ndahen me institucionet relevante dhe do të mund të shërbejnë gjatë miratimit të zgjidhjeve të reja ligjore për standardin studentor.

Në fund të shtatorit u zhvillua punëtori treditore të grupeve të punës për përgatitje të propozim-ndryshimeve të ligjeve për arsimin fillor dhe të mesëm. Në grupet e punës ishin kyçur shtatëdhjetë mësimdhënës, drejtorë, përfaqësues të BZA, MASH, ISA, Sindikata dhe disa organizata joqeveritare. Propozim-ndryshimet ishin dorëzuar tek shërbimi juridik i MASH-it që i përgatit propozim-ndryshimet e ligjeve.

Me mbështetjen tonë, Forumi Rinor Arsimor ka zbatuar një proces të konsultimeve me studentët e katër qendrave universitare, për atë se çfarë organizimi studentor preferojnë. Në tryezë të rrumbullakët të zhvilluar më 30 nëntor 2017, studentët kanë prezantuar propozim-dokumentin me të cilin kërkohet nga MASH-i, Parlamenti Studentor të bëhet një trup në kuadër të universitetit që do të kontrollojë punën financiare, dhe jo si deri më tani, të figurojë si organizatë joqeveritare. Ishte kërkuar edhe ndryshim i mënyrës së zbatimit të zgjedhjeve studentore, si dhe zgjerim të pjesëmarrjes së studentëve në gjithë trupat më të rëndësishme të fakulteteve. Ministrja ka premtuar që do të shqyrtohen gjithë propozimet, ndërsa zgjidhjet e propozuar do të integrohen në ligjin e ri Ligji për Arsim të lartë, që është në përgatitje.

Në fund të vitit 2017 ka filluar pilotimi i komponentit për promovim dhe nxitje të integritetit ndëretnik dhe përfshirje në arsim, që fillimisht ishte planifikuar për vitin 2018. Në thirrjen për grante të vogla për mbështetje të iniciativave për arsim të përfshirë, janë paraqitur 53 organizata. Në raundin e parë ishin zgjedhur 6 projekte ndërsa raundi i dytë i përzgjedhjes do të zhvillohet në fund të janarit 2018.

Me qëllim të kthimit të vëmendjes së opinionit drejt gjendjeve në arsim, në bashkëpunim me Forumin Rinor Arsimor ishte zbatuar fushata “Në orë”. Në Radio FRA ishin krijuar 38 përmbajtje: 27 analiza të autorit dhe artikuj, 3 shkrime, 1 video, 2 intervista dhe 10 emisione drejtpërdrejtë të cilat ishin të ndjekur nga rreth 125.000 vizitorë. Emisioni i rregullt mediatik “Në orë”, emisioni i parë për arsimin në eterin maqedonas, ka pasur 10 episode me 28 mysafirë, në të cilat ishte

diskutuar për metodiken mësimore dhe didaktikën, për organizimin studentor dhe të shkollave të mesme dhe arsimit përfshirës, tekstet mësimore, mobiliteti dhe praktika. Videoja e parë nga fushata, dedikuar rokit grupit prej nxënësve në “Braka Ramiz i Hamid” e kanë shikuar 22.000 shikues. Nga përmbajtjet tekstuale, analizat më të lexuara të autorëve ishin ato për dhunën në shkollat, konviktet studentore, arsimi seksual, akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë, reformat në arsim, dhuna në shkollat dhe strategjia për arsimin.

|| KORNIZA E PËRBASHKËT PËR PËRFORCIM JURIDIK

Në vitin 2017, FShHM-ja ka vazhduar me zbatimin e Kornizës së Përbashkët për Përforsim Juridik, që ka për qëllim që deri më vitin 2020 të krijojë një kornizë për përforsim juridik (PJ), me anë të partneritetit të vendosur mes përfaqësuesve të institucioneve relevante shtetërore, autoriteteve lokale dhe organizatave qytetare dhe furnizuesit e ndihmës ligjore dhe para ligjore, me qëllim që bashkërisht të punojnë në procesin e institucionalizimit të përforsimit juridik dhe avancimit të financimit të formave të ndryshme të furnizimit të qasjes në drejtësi për komunitetet e marginalizuara në nivelin lokal dhe kombëtar (romët, punëtorët seksual, përdoruesit e drogave, punëtorët e tekstilit, etj.).

Në rrugën drejt arritjes së qëllimit kryesor, për këtë vit ishin vendosur nën-qëllimet vijuese:

1) Përdorimi i zbulimeve nga hulumtimet për përfaqësim në nivelin lokal dhe kombëtar, si dhe për ndikimin e autoriteteve lokale të marrin për obligim kyçjen e shërbimeve ligjore në komunitet me anë të bashkëpunimit me anëtarë relevante të përfshira:

Për shkak të gjendjes politike dhe mos funksionimit të institucioneve që kanë shënuar vitin 2017, zbatimi i aktiviteteve të përfaqësimit të drejtuar për institucione konkrete nuk ka mundur të realizohet në tërësi. Ishte shfrytëzuar mundësia për pjesëmarrje aktive në përgatitjen e ligjit të ri Ligji për Ndhimë Juridike Falas (LNJF), janë përgatitur dy dokumente për politika publike në të cilat ishin përfshirë mungesat e përcaktuara dhe rekomandimet për tejkalimin e tyre. Madje në fund të vitit, pas emërimit të autoriteteve të reja lokale, ishin bërë hapat e para në planifikimin e bashkëpunimit me vetëqeverisjen lokale në komunën Shuto Orizarë, me qëllim që në vitin 2018 të fillohet me kyçjen institucionale të PJ në politikat e komunës. Në nivelin kombëtar, me Ministrinë e Pinës dhe Politikës Sociale janë filluar biseda për mundësitë e lidhjes ndër sektoriale dhe kyçje të PJ-së në programet përkatëse të ministrisë. Duke marrë parasysh gjendjen e pavolitshme politike, kjo periudhë ishte përdorur për përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve hulumtuese me qëllim të sigurimit të njohurive dhe argumenteve për përfaqësim pasi që të ndodh ndryshimi në kontekstin. Përveç hulumtimeve të zbatuara gjatë vitit paraprak, janë zbatuar edhe: hulumtim të nevojave ligjore të romëve; analiza e shpërndarjes së shërbimeve falas të ndihmës juridike nga ana e avokatëve në RM, me qëllim të nxitjes së debatit të gjerë mes opinionit profesional në lidhje me nevojën dhe mundësitë për sigurim të shërbimeve falas për ndihmën juridike; vlerësim i zbatimit, efikasitetit dhe efektivitetit të mekanizmave ligjore

aktuale për zgjidhjen alternative të kontesteve në zgjidhjen e problemeve dhe lehtësimi i qasjes në drejtësi për grupet më të cenuar të qytetarëve në Maqedoni (persona që jetojnë në varfëri të madhe, gratë, fëmijët, romët, viktimat e dhunës familjare, përdoruesit e drogave, LGBTI popullata dhe punëtorët seksual); analizë të shpenzimeve dhe përfitimeve për sigurimin e tre modaliteteve aktuale të ndihmës juridike dhe shërbimeve (ndihma juridike paraprake, që sigurojnë shoqata të autorizuara sipas LNJF; ndihmë juridike falas që sigurojnë organizatat jashtë sistemit të LNJF dhe ndihma para ligjore); hulumtim të kënaqësisë së qytetarëve nga NJF e fituar; zbatim i procesit fillestar për analizë dhe planifikim për shkrirje të Qëllimit 16.3 – Promovimi i Sundimit të së Drejtës në Nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar dhe sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi për gjithë në nivelin kombëtar. Me qëllim të arritjes së promovimit më të gjerë dhe njoftimit të opinionit me koncepti ne PJ, kjo periudhë ishte përdorur për përgatitjen e Strategjisë Komunikuese për Përforcimin Juridik, që do të realizohet gjatë vitit 2018.

2) Krijimi i sinergjisë dhe përforcimi i kapaciteteve të anëtarëve të rrjetit joformal të organizatave qytetare (OQ) që sigurojnë ndihmë juridike/para juridike në komunitetet:

Në fillim të iniciativës për PJ, FShHM-ja ka nisur formimin e një rrjeti joformal të 19 organizatave qytetare që punojnë në ndonjë formë të sigurimit të ndihmë paraprake juridike sipas LNJF, ndihmë juridike falas që sigurojnë organizata që janë jashtë sistemit të LNJF dhe ndihmë juridike/para juridike në komunitetet. Me qëllim të arritjes së lidhjes më të madhe mes organizatave dhe kuptim të unifikuar për qëllimet në kuadër të kornizës së përbashkët për PJ, në vitin 2017 është përgatitur një Strategji e Përbashkët për Përforcim Juridik për periudhën 2017-2019. Përveç aktiviteteve për përgatitje të Strategjisë, organizatat ishin në mënyrë aktive të kyçur në shumë trajnime dhe internet seminare për përforcimin e kapaciteteve: përdorimi i veglave për TI dhe rrjeteve sociale për përforcim juridik me qëllim të përfitimit të shkathtësive për avancimin e mekanizmave dhe shërbimeve për qasje në drejtësi, të zgjerohet shtrirja e grupeve synuese dhe të vendoset bashkëpunim me palët tjera të interesuara; trajnim për financim inovativ të dy moduleve - i pari me qëllim të njohjes me konceptet e mënyrave inovative që janë të suksesshme në shtetet ballkanike dhe evropiane, për të mundur të përdorin në gjetjen e mjeteve financiare për sigurim të shërbimeve juridike; e dyta do të realizohet në vitin 2018, me qëllim të shqyrtohen konceptet konkrete për financim inovativ, dhe zbatimi do të mbështetet nga FShHM financiarisht; internet seminare për TI strategji për përforcim juridik; bashkëpunim me donatorët/modelet për mbledhjen e mjeteve për përforcim juridik dhe përvoja të mësuara nga institucionalizimi i profesionit para juridik ose ligjor. Ishin zhvilluar dy trajnime për përforcim të njohurive dhe shkathtësive të 39 para ligjorëve nga 6 organizata në fushën e: relacioneve të punës; Kodi Penal dhe procedura penale; familja dhe e drejta familjare; bazat e sistemit ligjor dhe veprimi i policisë; dhuna familjare; mbrojtja shëndetësore; sigurimi shëndetësor; dhe të drejtat e pacientëve.

3) Mbindërtimi i shërbimeve juridike në komunitet me anë të rritjes së numrit të shërbimeve për grupet synuese (të varfrit, romët, punëtorët social dhe gratë që punojnë në industrinë e tekstilit, personat që përdorin droga dhe

komunitetet tjera të marginalizuar) dhe lidhja e modaliteteve të ndryshme të shërbimeve juridike/para juridike:

Për më tepër se 1.200 romë në 8 komunitete rome është siguruar ndihmë juridike dhe para juridike në drejtim të: të drejtat e pacientëve; diskriminimi; pagesa e paligjshme për shërbime shëndetësore; sigurimi shëndetësor dhe social; dokumentimi personal; ndihma sociale dhe kujdesi për person tjetër; shëndeti reproduktiv dhe tjera; janë filluar 4 raste të ligjitimit strategjik për gabim mjekësor të identifikuar. 12 para ligjor të trajnuar nga 3 organizata qytetar rome në 3 komuna, me anë të vizitave në teren të 1.200 amvisërive, kanë siguruar informim sistematik të të drejtave dhe mundësive për sigurimin e ndihmës para juridike, identifikim të problemeve ligjor dhe monitorimi i vazhdueshëm i shkeljeve individuale të të drejtave të njeriut. Janë zhvilluar 20 punëtori edukative për rreth 500 qytetarë rom për temat vijuese: imunizimi; të drejtat e pacientëve; sigurimi shëndetësor dhe social; mbrojtja shëndetësore dhe kontrole mjekësore falas; programe për mbrojtje parandaluese shëndetësore; shëndeti i grave; shërbime nga shërbimet patronazhe, etj. Në kuadër të aktiviteteve për qasjen e integruar për llogaridhënie sociale dhe përforcimit juridik, me qëllim të avancimit të qasjes së popullatës rome në shërbimet për mbrojtje shëndetësore, janë përgatitur propozim strategji për përfaqësim në nivelin lokal (Shuto Orizarë, Dellçevë, Pehçevë dhe Vinicë) dhe strategji kombëtare. Si forma të veçanta të mobilizimit të komuniteteve rome për pjesëmarrje në përforcimin juridik, të aq. Parlamenti Qytetar Rom dhe Iniciativa e Grave Rome nga Shuto Orizare, kanë vazhduar me aktivitetet e tyre edhe në vitin 2017.

Përforcimi juridik është mbështetur edhe me aktivitete mediatike në formë të artikujve të rregullta synuese në radiot dhe TV lokale, si dhe me anë të mediave sociale.

Tek 5 organizata të regjistruara për NJF janë drejtuar 1.023 qytetarë, shumica e tyre në fushën e mbrojtjes sociale; relacionet familjare; relacionet pronësore-juridike; mbrojtja e fëmijëve dhe mbrojtja e viktimave të dhunës familjare; 50 qytetarë kanë parashtruar kërkesë për NJF para Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar avokat falas që do të përfaqësojë ata në gjykatë. Janë zbatuar 15 seanca për përforcim juridik, në të cilat qytetarët janë njoftuar me të drejtat e tyre dhe obligimet nga fusha e mbrojtjes sociale, relacionet e punës, zbatimi, dhuna e bazuar në gjini, etj.

Janë siguruar 320 shërbime juridike për 41 punëtorë seksual, është mundësuar qasje dhe këshillime juridike për 89 punëtorë seksual që punojnë në skenë të mbyllur. Është siguruar përfaqësim gjyqësor në rast të: diskriminim të personave që përdorin droga; fëmijë të punëtorëve seksual, viktimat të dhunës dhe diskriminimit racor; urrejtje ndaj trans personave që janë edhe punëtorë seksual; 6 raste gjyqësore për njohje ligjore të gjinisë (një prej këtyre rasteve është nisur në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut). Për 85 persona që përdorin droga janë siguruar 551 shërbime juridike, gjatë së cilës janë përfshirë edhe personat të dalë nga burgu, që nuk posedojnë dokumente për identifikim personal, sigurim shëndetësor dhe trajtim përkatës pas daljes nga burgu. Janë përcaktuar parregullsi tek punëdhënësit e industrisë së tekstilit – rroga të papaguara dhe

kontribute të rrogave për 201 persona; shtesë të papaguar të rrogës për orë të kaluara në ditë për pushim javor dhe shtojcë të rrogës për orë të kaluara të punës gjatë festave dhe ditëve që nuk punohet tek 1.052 persona; regres i papaguar për pushim vjetor, pagesë e rrogave në dorë, ndërprerja e paligjshme e relacioneve të punës, relacione të parregulluar të punës, punë jashtë orarit mbi minimumin e lejuar ligjor, mobing, shkelje të përcaktuara tek 321 persona; punë në kushte të pavolitshme shëndetësore dhe sanitare, kushte të pasigurta për siguri dhe shëndet gjatë punës, shkelje të së drejtës për përdorim të pushimit vjetor, punë gjatë festave shëndetësore tek 471 person; janë nisur 2 procedura gjyqësore dhe 16 procedura administrative për shkelje të të drejtave të punëtorëve; 2.262 punëtorë të tekstilit prej gjithsej 56 fabrikave kanë denoncuar shkelje të të drejtave të tyre të punës; Gjykata Themelore e Kriva Pallankës ka marrë vendimin me të cilën është miratuar kërkesa e 105 punëtorëve të tekstilit.

Janë dhënë 21 grante, prej të cilëve 9 për organizata qytetare që sigurojnë ndihmë juridike ose para juridike për grupet e synuara dhe 5 organizatave të autorizuara qytetare që sigurojnë ndihmë juridike falas, duke përdorur LNJF. Grantet tjera janë dhënë për zbatim të aktiviteteve tjera të nisur në kuadër të Kornizës së Përbashkët për Përforcim Juridik.